LEXIMI I KUR'ANIT DHE NDRYSHIMI I KURSIT TË ZEMRËS...

PËRSE ALLAHU E KA KRIJUAR TË KEQEN (SHERRIN)?

SHKODRA, SHEMBULL I BASHKËJETESËS NDËRFETARE!

Viti 17 - Nr. 10 (200),
Tetor, 2019

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO PËR VIZITË NË SHKODËR

Lypset që secili prej nesh ta prezantojë sa më mirë Islamin, si një fé e paqes dhe e bashkëpunimit në mesin e njerëzve.

- Dr. Salahudin A. Keftaro -

LEXIMI I KUR'ANIT DHE NDRYSHIMI I KURSIT TË ZEMRËS...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

"NE, KUR'ANIN E BËMË TË LEHTË PËR MËSIM..."

Hadithi: "Më i miri i njerëzve është ai që më së miri e lexon Kur'anin...", është një ftesë e hapur nga Resulullllahu (a.s.), që të shohim në thelb të marrëdhënies që kemi me Kur'anin Famëlartë.

Zoti i gjithësisë e shpalli këtë Libër dhe e zbriti atë për të mirën e njerëzisë, për udhëzimin dhe lumturimin e tyre, që të jetojnë në paqe me veten e me Zotin, me shoqërinë e me tjetrin, kushdo qoftë ai.

Në suren e hënës, El-Kamer, në ajetin 17, urdhëron: "Ne, Kur'anin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësim?". Ky ajet në vetvete është argumenti më i qartë që vërteton se, njeriut i është lehtësuar rruga drejt Kur'anit; mësimit të shkronjave të tij, leximit të rrjedhshëm të tij, mësimit të rregullave të shqiptimit të tij, kuptimit të tij e, mbi të gjitha praktikimit të tij në jetë.

Sa e sa qendra të specializuara për mësimin përmendësh të Kur'anit, anëmbanë globit, nxjerrin çdo vit hafizë të panumërt? Sa e sa çmime ndërkombëtare për të promovuar angazhimin e rinisë me mësimin dhe leximin e Kur'anit? Sa e sa botime të Kur'anit në formate të larmishme, si e si për ta bërë atë të përshtatshëm për krejt njerëzit? Sa e sa përkthime të kuptimeve të përafërta të ajeteve të Kur'anit, deri në gjuhë, që as e dijmë se ekzistojnë, në vende që nuk e dijmë se ku bien? Sa e sa komplete audio të leximit të Kur'anit nga lexues nga më të afirmuarit në botë? Sa e sa pajisje të avancuara, që e mundësojnë dëgjimin e Kur'anit, përsëritjen e tij, a mësimin e tij, sipas arritjeve të reja të teknologjisë?

A nuk janë këto mundësi, argument për të gjithë ata që hezitojnë të ulen e të mësojnë leximin e Fjalës së Allllahut, por edhe një ftesë plot finesë drejt angazhimit për ta lexuar, mësuar e shijuar çdo harf prej shkronjave të Kur'anit Famëlartë, Librit të vetëm, që është ruajtur mrekullisht tash 15 shekuj, duke mos ndryshuar as edhe një pikë e vetme e qoftë edhe një shkronje të vetme prej tij!?

Prandaj, të dashurit e mi, ftesa e Pejgamberit (a.s.) për të fituar dëshminë e mirësisë nëpërmjet mësimit e leximit të drejtë të Kur'anit, është një ftesë e mrekullueshme që na zgjon nga hutimi e na merr për dore drejt shkallëve më të larta të afrimit me Zotin dhe dëshmimit tonë si mëkëmbës të Tij, nëpërmjet angazhimit dhe përkushtimit tonë ndaj Kur'anit Famëlartë.

(Nga dersi i sabahut, më 9/10/2019, në xhaminë e Parrucës)

A BESOJMË NE NË KUR'ANIN FAMËLARTË?

Në Kur'anin Famëlartë, në suren El-Bekare, në ajetin 185 lexojmë se: "Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin nisi të zbriste Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)".

A e besojmë ne realisht këtë ajet? A besojmë ne në të vërtetë se Kur'ani është udhërrëfyes për jetën tonë? Sepse, besimi në vërtetësinë e këtij ajeti do të thotë se edhe vepra e secilit prej nesh duhet të përshtatet sipas thirrjes dhe udhëzimit kur'anor!

Por, a janë veprat tona dëshmuese të këtij besimi?

(Nga dersi i sabahut, më 14/10/2019, në xhaminë e Parrucës)

SEKRETI KRYESOR I PËRPARIMIT TË MUSLIMANËVE

Sekreti kryesor i përparimit të muslimanëve në çdo kohë është Kur'ani!

Prandaj, e kemi për detyrë t'i themi fëmijëve tanë, rinisë tonë, grave tona, të afërmve e shoqërisë tonë: Kthehuni nga Kur'ani se aty është sekreti i përparimit tonë në çdo kohë!

Sepse një person me Kur'an në zemër e mendje, është garanci e të mirës me këdo e kudo qoftë!

Një person që e kupton Fjalën e Allllahut të Madhëruar dhe e praktikon atë në përditshmërinë e marrëdhënieve të tij me të tjerët, është pa dyshim një individ i shëndosh që i bën mirë vetes, familjes, shoqërisë, atdheut e mbarë njerëzimit!

Mbrëmë, një mik i shtrenjtë, prej haxhilerëve tanë të dashur, më tregoi se në 20 vitet e fundit e kishte lexuar Kur'anin 40 herë. Pra, 2 hatme në vit. Që do të thotë se, në krye të gjashtë muajve ai përfundon leximin e plotë të përkthimit të kuptimeve të Kur'anit në gjuhën shqipe. Dhe, kjo është një shtysë më shumë drejt kuptimit të Fjalës së Allllahut dhe përvetësimit të dritës së saj në jetë!

ZOTI I GJITHËSISË E SHPALLI KËTË LIBËR DHE E ZBRITI ATË PËR TË MIRËN E NJERËZISË, PËR UDHËZIMIN DHE LUMTURIMIN E TYRE, QË TË JETOJNË NË PAQE ME VETEN E ME ZOTIN, ME SHOQËRINË E ME TJETRIN, KUSHDO QOFTË AI.

Sot, nuk kemi nevojë të mburremi me numra, as me shifra, porse kemi nevojë të kthehemi nga Kur'ani për ta lexuar e kuptuar, për të adhuruar Zotin e me leximin e tij në origjinal, si dhe për t'u afruar drejt Tij me praktikimin e asaj që lexojmë në jetën e përditshme!

E pyetën një të urtë që jetonte vetëm se, a mërzitej në vetminë e tij? Ai ia ktheu: Kur dua të më flasë Zoti, lexoj Kur'anin e, kur dua t'i flas, ngrihem dhe fali dy rekate!

All-llahu na udhëzoftë drejt dritës së Kur'anit dhe na mbuloftë me mirësi e bekim, ne, shoqërinë tonë dhe mbarë njerëzimin!

(Nga dersi i sabahut, më 21/10/2019, në xhaminë e Parrucës)

KUR'ANI FAMËLARTË, SI CAK UDHËZIMI DHE GARANCI E HYJNORES NË JETË

Argumente të shumta logjike na ftojnë përherë e më shumë drejt forcimit

NËSE NUK BËHEMI RREGULLATORË, NUK DO NA VLEJË TË JEMI PREJ TË MIRËVE!

Në Kur'anin Famëlartë lexojmë se vepërmirët e përkushtuar do të kenë shpërblime të mëdha në jetën e përtejme.

Në suren Edh-Dharijat: 15-16, urdhëron e thotë: "Të përkushtuarit janë në kopshte e burime. Të kënaqur se kanë shtënë në dorë atë që u dha Zoti i tyre, ata edhe më parë (në jetën e mëparshme) ishin mirëbërës!".

Këto dy ajete na japin të kuptojmë se përkushtimi në jetë, ndjekja e udhëzimit hyjnor dhe distancimi nga ndalesat e Tij, shoqëruar me vullnetin për të bërë mirë e për të përsosur çdo gjë që kemi në dorë, na mundëson shpërblimin e madh në jetën e përtejme.

Mirëpo, a mjafton të jemi vepërmirë dhe të mjaftohet secili me veten e tij?

Në Kur'anin Famëlartë lexojmë: "E Zoti yt nuk do të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë rregullatorë" - (Hud: 117)

Me fjalë të tjera, kemi nevojë të zgjohemi e ta përhapim fjalën e mirë të besimit e fesë në mesin e njerëzve, duke nisur me familjen, farefisin, rrethin e ngushtë, shoqërinë e njeriun, cilido qoftë ai! Sepse muslimani është vepërmirë, që i do të tjerëve atë që do për veten e tij!

Kemi nevojë të refuzojmë thirrjet e përditshme që e marrin shoqërinë për dore drejt shthurjes, injorancës, afetarizmit, degradimit moral, prishjes së ekuilibrave të natyrës, deformimit të familjes, prishjes së tabanit kombëtar të vlerave të trashëguara, por jo vetëm!

Kemi nevojë të ngrihemi për të refuzuar të keqen, për të mos u bërë palë me të, për ta dëshmuar kudo besimin dhe moralin e tij!

Resulull-llahu (a.s.) na tërheq vëmendjen: "Si do të veproni atë ditë kur do të devijojnë të rinjtë tuaj dhe do të shthuren gratë tuaja?" I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i All-llahut? Tha: "Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!" I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: "Si do të veproni atë ditë, kur nuk do të urdhëroni më për të mirë dhe s'do e ndaloni më të keqen?" I thanë: A do të ndodhë kjo, o i Dërguar i Allllahut? Tha: "Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!" I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: "Si do të veproni atë ditë, kur do të urdhëroni për të keq dhe do ta ndaloni të mirën?" I thanë: Edhe kjo do të ndodhë, o i Dërguar i Allllahut? Tha: "Edhe më shumë se kaq do të ndodhë!" I thanë: E çfarë mund të jetë më shumë se kaq? Tha: "Si do të veproni atë ditë, kur do ta shihni të mirën të keqe dhe të keqen të mirë?!".

Me pak fjalë: Nëse nuk bëhemi rregullatorë, nuk do na vlejë të jemi prej të mirëve!

Imam Muhamed B. Sytari

(Nga hytbeja e xhumasë, më 25 tetor 2019, në xhaminë e Tophanës)

---

të besimit të patundur se, Kur'ani është Fjala e All-llahut të Madhëruar.

E, teksa argumentet na dëshmojnë bindshëm se, ky Kur'an është Fjala e All-llahut të Madhëruar, përse të mos ia hapim zemrën e shpirtin? Përse të mos e përqafojmë e ta ndërtojmë jetën tonë mbi thirrjen e tij? Përse të mos i dëshmojmë Zotit tonë se, ne muslimanët e kësaj kohe, e kemi plotësisht të mundur të jemi elitë, nëpërmjet kthimit tonë nga Kur'ani?

Në suren Et-Tur: 33-34, lexojmë: "A mos ata thonë: "Ai (Muhammedi) e trilloi!" Jo, por ata nuk besojnë. Pra, nëse ata janë të drejtë le ta sjellin një ligjërim si ai."!

Nëpërmjet këtyre dy ajeteve kuptojmë se edhe në kohën kur u dërgua me Kur'an, Resulull-llahu (a.s.) u përball me shpifjet dhe trillimet e kundërshtarëve të tij, që vinin në dyshim prejardhjen e Kur'anit.

Por, po të trajtojmë me qetësi pretendimin se, Kur'ani është libër i shkruar nga Hz. Muhammedi (a.s.), do të shohim se sa paradoksal dhe i pakuptimtë është!

Në vitin 2003, në librin tim me titull: "Përpjekje të dështuara", trajtova edhe këtë çështje, që e shkoqita në tetë pika kryesore.

Gjithësesi, përtej thirrjeve të shkuara e atyre të kohës moderne, Kur'ani Famëlartë vazhdon të befasojë njerëzit e ditur dhe intelektualët objektivë, për bukurinë e fjalisë, për thellësinë e kuptimeve, për korrektësinë në marrëdhënie me çdo të dhënë shkencore e historike, për vlerat edukuese, për mesazhet e shpresës, për gjurmët e mrekullueshme të pejgamberëve të shkuar dhe shembullin e përkushtimit të tyre, etj.

(Nga dersi i sabahut, më 22/10/2019, në xhaminë e Parrucës)

LEXIMI I KUR'ANIT DHE NDRYSHIMI I KURSIT TË ZEMRËS

Ajeti kur'anor 53 i sures Fussilet: "Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?", është argument, që na fton të mendojmë thellë rreth mirësisë së madhe të pranisë së Kur'anit Famëlartë në mesin tonë, si shoqërues besnik i njeriut në botën e tij kalimtare.

Le të ndalemi për pak te mënyra dhe shkaku i hyrjes në Islam të Hz. Omerit (r.a.). Ai ishte nisur të vriste të Dërguarin e All-llahut, por rrugës drejt vendit, ku ndodhej Resulull-llahu (a.s.), Omerit i ndryshoi kursi i zemrës. U bë musliman në mes të rrugës, pas një incidenti (në pamje të parë) me të motrën dhe dhëndrrin e tij...

Që do të thotë se, zemrat e njerëzve janë në dorën e Zotit dhe udhëzimi është çështje ekskluzivisht në vullnetin e Krijuesit të gjithësisë.

Por, duke u kthyer tek Hz. Omeri dhe momenti kulminant, pas të cilit ai u bë musliman, do të kuptojmë se mjaftuan disa ajete kur'anore që zemra e tij të ndryshonte rrahje. Lexojmë së bashku: "Ta, Ha. Ne nuk ta shpallëm Kur'anin mjerim për ty! Ta shpallëm vetëm këshillë (përkujtim) për atë që frikësohet. Shpallje nga Ai që krijoi tokën dhe qiejt e lartë. (E Ai është) Mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë." - (Kur'ani Ta Ha: 1-5).

Pyetja që duhet t'i drejtojmë vetes, teksa e lexojmë Kur'anin, është: A ndikon leximi i sotëm i Kur'anit, që zemrat tona të ndryshojnë kurs, duke u kthyer përherë e më shumë drejt udhëzimit dhe veshjes me moralin e Librit të All-llahut?

Kjo është një pyetje, që ia vlen ta marrim në konsideratë, për të kuptuar cilësinë e marrëdhënies që kemi me Fjalën e Zotit dhe vërtetësinë e komunikimit tonë me të!

(Nga dersi i sabahut, më 23/10/2019, në xhaminë e Parrucës)

PËRSE ALLAHU E KA KRIJUAR TË KEQEN (SHERRIN)?

Dr. Mustafa Mahmud

Miku im duke u tallur më tha:

Si pretendoni se Zoti juaj është i Plotë, i Mëshirshëm, Mëshirëbërës, Bujar, i Dhembshur dhe ndërkohë ka krijuar të gjitha këto të këqija në botë... sëmundjen, pleqërinë, vdekjen, tërmetet, vullkanet, mikrobet, helmin, vapën përvëluese, dhimbjet e kancerit, i cili nuk fal as fëmijën e porsalindur dhe as plakun e moshuar.

Nëse Allahu është dashuri, bukuri, mirësi, atëherë si e krijon urrejtjen, shëmtinë dhe të keqen?

Problemin, të cilin e nxiti miku im është prej problemeve kryesore në filozofi, ku për shkak të saj shkollat e mendimit janë ndarë dhe kanë mendime të ndryshme për këtë gjë.

Ne themi, se Allahu është i gjithi mëshirë, është i tëri mirësi dhe nuk ka urdhëruar për keq (për sherr), por Ai e ka lejuar atë për një urtësi.

"Allahu nuk urdhëron për të këqija, a po thoni për Allahun atë që nuk e dini? Thuaj: Më ka urdhëruar Zoti im për drejtësi dhe të jeni të sinqertë në çdo adhurim". – (Kur'ani, El-Araf: 28-29)

Allahu nuk urdhëron, vetëm se për drejtësi, për dashuri, për bamirësi, për falje, për mirë dhe Ai nuk pranon, vetëm se të mirën.

Përse e lë zullumqarin të bëjë zullum, vrasësin të vrasë dhe hajdutin të vjedhë?

Sepse Allahu ka dashur për ne të jemi të lirë dhe liria përfshinë gabimin dhe nuk ka kuptim liria pa pasur ne të drejtën e përvojës, të gabimit dhe të saktës.

Përzgjedhja e lirë është mes mëkatit dhe bindjes (nënshtrimit).

Ka qenë në fuqinë e Allahut të na krijojë të gjithëve të mirë dhe kjo duke na detyruar të nënshtrohemi (bindemi) me forcë, e kjo gjë do të thoshte të na merrte lirinë e zgjedhjes. Në ligjin e Allahut dhe praktikën e Tij, liria me dhimbje është më fisnike për njeriun se sa skllavëria me lumturi. Për këtë arsye na ka lënë të gabojmë, të ndjejmë dhimbje dhe të mësojmë, e kjo është urtësia e lejimit të Tij të së keqes (sherrit).

E megjithatë, vështruesi i drejtë e kritik do të na zbulojë, se e mira në ekzistencë, ajo është baza dhe se e keqja ajo është përjashtim.

Shëndeti është baza, ndërsa sëmundja është përjashtim. Ne kalojmë pjesën më të madhe të viteve të jetës sonë në shëndet dhe sëmundja nuk na viziton, vetëm se në ditë të pakta. Njësoj edhe tërmetet, ato në tërësinë e tyre janë disa minuta në moshën e rruzullit tokësor, i cili llogaritet me miliona vite. Kështu edhe vullkanet; kështu edhe luftërat, ato janë irritime (dhimbje) të shkurtra në jetën e popujve mes periudhave të paqes të gjata e të shtrira në kohë.

Pastaj, ne çdo gjësë i shohim anën e mirë, kështu sëmundja lë prapa mbrojtje, dhimbjet kalisin rezistencën, forcën dhe durimin; tërmetet janë frymëmarrje nga presionet e ndrydhura brenda rruzullit tokësor, mbrojnë koren e tokës prej shpërthimit dhe i kthejnë malet në vendin e tyre, si rripa sigurimi dhe pesha të rënda që mbajnë koren e tokës në pozicionin e saj. Vullkanet nxjerrin mineralet dhe pasuritë e fshehta nëntokësore të dëmshme dhe mbulojnë tokën me dheun pjellor vullkanik. Luftërat ndërthurin popujt, integrojnë dhe i bashkojnë në grupe dhe aleanca, pastaj në kështillin e sigurimit, që është në vendin e një gjykate ndërkombëtare për ankesa dhe pajtime. Shpikjet më të mëdha kanë dalë gjatë luftërave; penicilina, atomi, raketat, avionët reaktiv, krejt kanë dalë nga flaka e luftës.

Prej helmit të gjarprit del antidoda (kundërhelmi).

Prej mikrobeve prodhojmë vaksinën.

Sikur gjyshërit tanë të mos kishin vdekur, ne nuk do të ishim në vendet tona dhe, e keqja në univers është sikur hija në fotografi, nëse afrohesh tek ajo, të duket sikur ajo është e metë dhe defekt në fotografi, por nëse largohesh dhe e shikon fotografinë si tërësi, me shikim gjithëpërfshirës do të zbulosh se ajo (hija) është e domosdoshme dhe nuk bën pa të dhe se ajo kryen një funksion zbukurues në ndërtimin e përgjithshëm të fotografisë.

A do të kishim pasur ne mundësi të njihnim shëndetin, sikur të mos ishte sëmundja. Shëndet qëndron kurorë mbi kokat tona, nuk e shohim dhe nuk e njohim, përveçse kur sëmuremi. E njëjtë është edhe kjo, se nuk do të mund të njihnim të bukurën, sikur të mos ishte e shëmtuara dhe as gjendjen normale, sikur të mos ishte devijimi (përjashtimi).

Për këtë arsye, filozofi Ebu Hamid El-Gazali thotë: Mangësia e universit është vetë perfeksionimi i tij, ashtu siç është përkulja e harkut vetë fuqia e tij, e sikur ai të ishte i drejtë, nuk do të gjuante.

Funksioni tjetër i vështirësive dhe dhimbjeve është, se ato janë të cilat nxjerrin në pah njerëzit dhe zbulojnë të vërtetën e tyre.

KA QENË NË FUQINË E ALLAHUT TË NA KRIJOJË TË GJITHËVE TË MIRË DHE KJO DUKE NA DETYRUAR TË NËNSHTROHEMI (BINDEMI) ME FORCË, E KJO GJË DO TË THOSHTE TË NA MERRTE LIRINË E ZGJEDHJES. NË LIGJIN E ALLAHUT DHE PRAKTIKËN E TIJ, LIRIA ME DHIMBJE ËSHTË MË FISNIKE PËR NJERIUN SE SA SKLLAVËRIA ME LUMTURI. PËR KËTË ARSYE NA KA LËNË TË GABOJMË, TË NDJEJMË DHIMBJE DHE TË MËSOJMË, E KJO ËSHTË URTËSIA E LEJIMIT TË TIJ TË SË KEQES (SHERRIT).

Sikur të mos ishin vështirësitë, njerëzit të gjithë do të udhëhiqnin... bamirësia largon varfërinë dhe trimëria është në luftë.

Ai është provimi, me të cilin njohim veten tonë dhe sprovimi, me të cilin përcaktohen gradët tona tek Allahu.

Pastaj, dynjaja nuk është tjetër, vetëm se një kapitull i vetëm prej tregimit, që do të ketë kapituj të tjerë, sepse vdekja nuk është fundi i tregimit, por fillimi i tij.

Ne nuk na lejohet të gjykojmë shfaqjen nga një pjesë e vetme dhe as të refuzojmë një libër, sepse faqja e parë nuk na ka tërhequr. Gjykimi këtu është i mangët.

Nuk mund ta vëmë re të tërë urtësinë, përveçse në fundin e udhëtimit. Pastaj, cili është zëvendësuesi, që e përfytyron pyetësi, i cili tallet me ne?!

A dëshiron të jetojë jetë pa vdekje, pa sëmundje, pa pleqëri, pa të meta, pa mungesë fuqie, pa kufizime, pa hidhërime, pa dhimbje.

A kërkon të plotën absolute?!

Por, e plota absolute është për Allahun.

I Ploti është Një dhe nuk shumësohet... e përse të shumësohet dhe çfarë i mungon, që ta gjejë te dikush tjetër, përveç Tij?!

Kuptimi i kësaj është, se mikun tonë nuk e kënaq, vetëm se të jetë vetë zot, e kjo me të vërtetë është mendjemadhësi.

Le të jetë edhe radha jonë të tallemi me të dhe me shokët e tij, të cilët nuk i kënaq asgjë.

Këta tipa të tillë dëshirojnë xhenet, por çfarë kanë bërë, që ta meritojnë xhenetin?

Çfarë i ka dhënë miku ynë njerëzimit, që ta bëjë veten e tij zot të vetëm e të plotfuqishëm, i cili i thotë diçkasë: bëhu dhe ajo bëhet menjëherë? Gjyshja ime ka qenë më e zgjuar, se profesori dhe doktori i diplomuar në Francë, kur thoshte me thjeshtësi: "E mira është nga Allahu dhe e keqja është prej nesh"!

Këto janë fjalë të pakta, por janë përmbledhje besnike e gjithë problemit.

Allahu e dërgon erën dhe i bën të rrjedhin lumenjtë, por kapiteni lakmitar i anijes e ka mbushur anijen plot me njerëz dhe me mallra, më tepër se sa ka kapacitet dhe ajo mbytet, e ai pastaj fillon të shajë Zotin dhe kaderin... cili është mëkati i Zotit?!

Allahu e dërgoi erën e mbarë dhe rrjedhën e lumit të mirë, por babëzia e njerëzve dhe lakmia e tyre, ajo është e cila e shndërroi këtë të mirë në sherr (në të keqe).

Sa fjalë të sinqerta, të mira dhe të bukura janë: "E mira është nga Allahu dhe e keqja është prej nesh"!

(Marrë nga libri: DIALOG ME MIKUN TIM ATEIST)

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

EDHE TI IKE, AXHË..!

Edhe ti ike, Axhë..! Të gjithë do të shkojmë, xhanëm; sot, nesër, pasnesër, a kushedi kur! Të gjithë kemi një orë, të cilës nuk i ikim dot. Ora e së vërtetës së madhe. "I madhëruar është Ai, që në dorën e fuqisë së Tij është i tërë sundimi dhe Ai ka fuqi mbi çdo send. Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Falësi i gjynaheve" - (Kur'ani, El-Mulk: 1-2).

Për një moment ora ndalet, ndonëse koha nuk e kthen kokën për njeri. Si në një shirit kujtimesh, shfaqen momente të paharruara, të mbushura me dritë e nostalgji, me dashni e pastërti, më mirësi e paqe... Janë ato momente që formësojnë memorien personale të njerëzve tanë të dashur në arkivat e zemrës e të shpirtit!

(Njerëzit zihen e lëndohen, ndahen e largohen, pastaj.., krejt papritur, pasi ka kaluar kohë e, tekat janë qetësuar, kthehen e paqtohen, pendohen e afrohen... Ah, njerëzit dhe koha e tyre.., koha dhe njerëzit e saj...)

Dhe, çasti i lajmit tënd, i dashtun Axhë, më zgjoi momentet e memories tënde të mbushur; çuditërisht, drita e tyre e lidh emrin dhe tiparet tuaja me dritën dhe mallin e Kupolës së Gjelbërt...

Kështu dua të të kujtoj e, këtu dua të të vendos në botën e kujtimeve të mia, ku jo çdo personazh ka këtë bukuri e këtë vulë..!

Para ca netësh, për herë të parë në jetë pashë lotë në sytë e tu. U befasova. Edhe ti loton? -, thashë me vete... T'u ndez malli i vizitës së Resulull-llahut (a.s.), kur pe veten në një shkrepje malli, para Kupolës së Gjelbërt...

Mjaftoi një foto për të zgjuar një botë malli, që fshihet qoshkeve të zemrës dhe, aty pret e duron, duke fshehur veten...

"Selam alejke...", të dëgjova, teksa e thoje me gjysëm zëri të mbytur nga malli... Po i drejtoheshe Zotërisë tënd nëpërmjet kujtimeve e, ndoshta, zemra ta ndjente se, takimi nuk do ishte i largët...

Edhe ti ike, Axhë..! Ike i dorëzuar! E pranove thirrjen e Zotit tënd, kur të erdhi ftesa e jetës..! Më kujtohet mirë ai moment i paharruar, kur u dorëzove në Shtëpinë e Tij, i mbushur me dritë e dashni, me të cilën u vulos pjesa e mbetur e jetës tënde kalimtare...

Subhanallah, si i ndryshon Zoti zemrat e robërve të Tij... U largove me namaz e agjërim, me umre e haxh, Haxhi Axhë i shtrenjtë... U largove me tespihë në dorë, me lutje e dorëzim të plotë para duarve të Krijuesit Tënd..!

Kjo ditë erdhi ndryshe. Nesër, nuk do jetë si dje. Sot, u zgjuan kujtime dhe u ndal koha jote, i dashtun Axhë! Ti e kalove pragun. Ne të tjerët, herët a vonë do të vijmë pas teje.

Deri atëherë, do vazhdoj të lutem për shpirtin tënd, do të të kujtoj të dorëzuar para duarve të Qabes, do të shoh çdo të xhuma nga minberi i xhumasë, do të çoj një selam për çdo ditë Arefati, do të këndoj për ty një "Fatiha" për çdo natë teravie, do të mbetesh gjurmë e bukur në një botë të vështirë plot dritëhije, sakrifica e përkushtim..!

All-llahu e pranoftë dorëzimin tënd, Haxhi..!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, 19 tetor 2019

ÇFARË ËSHTË XHENETI, SI ËSHTË AI?

A janë të përhershëm Xheneti dhe Xhehenemi? Si përshkruhet Xheneti? Si do të jetë ai? Çfarë ka në Xhenet? Cilat janë mirësitë e tij? A do ta shohim Allahun në Xhenet? Si fitohet Xheneti? Çfarë duhet të bëjmë për të hyrë në Xhenet? Kush do të hyjë në Xhenet? Cilat janë ajetet dhe hadithet në lidhje me Xhenetin? Le të lexojmë më poshtë përgjigjet e këtyre pyetjeve shumë domethënëse...

KUSH PËRFITON NGA MIRËSITË E XHENETIT?

Hadithet profetike na mësojnë se në Xhenet do ketë pallate prej kristali, të tejdukshëm për ato persona që "Kur flasin përdorin fjalë të ëmbla dhe të bukura, ushejnë të tjerët, agjërojnë dhe ndërsa të gjithë flenë ata janë të zgjuar duke falur namaz për hir të Allahut!" *(Tirmidhi, Xhennet, 3/2527, Birr, 53/1984)*

I dërguari i Allahut ka thënë: Në Xhenet besimtarit i jepet një tendë shumë e gjerë dhe e punuar me perla të shpuara[1]Lartësia e saj drejt qiellit është tridhjetë(apo gjashtëdhjetë)milje. Në çdo cep të saj gjendet nga një hyri për besimtarin dhe ato nuk e shohin njëra-tjetrën. *(Buhari, Bedu'l-Halk 8, Tefsir 55/2; Muslim Xhenet, 23-25)*

Në një tjetër transmetim thuhet se i Dërguari i Allahut ka thënë: "Banorët e Xhenetit hanë e pinë, por nuk pështyjnë kurrë, nuk kryejnë nevojat personale dhe nuk nxjerrin sekrecione nga hundët."[2]

Sahabet të çuditur, pyetën me habi: Po atëherë si do mënjanojnë ushqimin e ngrënë?

I Dërguari i Allahut u përgjigj: "Ata do nxjerrin vetëm një gromësirë me aromë të mirë dhe një djersë me që mban erë misku. Ata do e madhërojnë dhe e falenderojnë Krijuesin fuqiplotë ashtu siç frymojnë vetvetiu." *(Muslim, Xhenet, 18)*[3]

"Banorët e Xhenetit do jetojnë në paqe dhe qetësi mes mirësive të pafundme dhe për to nuk do ketë asnjë shqetësim, apo brengë. Sytë e tyre do jenë të lyer dhe trupi i pastër nga qimet dhe pushi. Ata do jenë jashtëzakonisht të bukur dhe të pashëm. Mosha e tyre do jetë 30 ose 33."[4]

Në Xhenet nuk do ketë lodhje dhe plogështi. Xheneti është aq i pastër dhe i dëlirë saqë nuk do ketë as pluhur. Në trupin e njeriut si psh.në hundë apo në veshë nuk do ketë papastërti. Askush nuk do ketë asnjë ves. Askush nuk do flasë fjalë të kota dhe të këqija. Banorët e Xhenetit do ta duan njëri-tjetrin dhe do dëshirojnë të shikojnë fytyrat e njeri-tjetrit.

I Dërguari i Allahut thotë: "Banorët e parë të Xhenetit do kenë fytyra të ndritshme si hëna e plotë. Ndërsa ata që vijnë pas tyre do kenë fytyra të ndritshme si ylli më i ndritshëm i qiellit. Aty njerëzit nuk do kryejnë nevojat personale, as pështyjnë dhe as nxjerrin sekrecione nga hundët. Krehëri i tyre është prej ari dhe djersa e tyre mban arome misku. Era e kemit[5] të tyre është nga drunjtë me aromë të këndëshme. Bashkëshortet e tyre janë hyritë. Banorët e Xhenetit janë krijuar në formën e babait të tyre, Ademit dhe gjatësia e trupave të tyre është sa 60 parakrahë." *(Buhari, Enbija 1, Bedu'l-Halk 8; Muslim, Xhenet, 14-19)*[6]

Ashtu siç bëhet me dije edhe në hadithet profetike, banorët e Xhenetit do kenë formën fizike të babait të njerëzimit, Ademit a.s. duke i ngjarë atij në gjatësi, bukuri dhe përsosmëri.Trupi i tij ka qenë 60 dhira.[7] Mirëpo që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, njerëzit kanë humbur dalëngadalë gjatësinë, bukurinë dhe kohëzgjatjen e jetës së tyre. Ndërsa në Xhenet të gjithë njerëzit do kenë të njëjtën gjatësi.[8]

Në një hadith tjetër thuhet se: "...Kupat e banorëve të Xhenetit do jenë prej ari... secilit prej tyre do i nga dy bashkëshorte të bukura. (Në Xhenet askush nuk do jetë beqar).[9] Banorët e Xhenetit nuk do kenë mosmarrëveshje dhe urrejtje mes vete dhe zemrat e tyre do jenë si një e vetme (në ndjenja). Ata do ta madhërojnë Allahun nga mëngjesi deri në mbrëmje." *(Buhari, Bedu'l-Halk 8, Enbija 1; Muslim, Xhenet 14, 17)*

Duke marrë shkas nga këta transmetime profetike nuk duhet të mendohet se gratë janë të privuara nga mirësitë dhe begatitë e pafundme të Xhenetit. Si burrat ashtu edhe gratë janë të barabartë para Krijuesit të Gjithësisë dhe kësisoj midis tyre ekziston një drejtësi unike. Megjithatë shpërblimet e Xhenetit janë në përputhje me natyrën e krijimit të secilës palë. Nëse këto transmetime bëjnë me dije për shpërblime të burrave me hyrijet e Xhenetit, për gratë këto mirësi dhe begati do jenë në përputhje me natyrën e krijimit të tyre. Gratë e Xhenetit do jenë të zbukurara në formën më të përsosur dhe të lartësuara në raport me hyritë e Xhenetit.

Po ashtu i Dërguari i Allahut ka thënë: "Xheneti është nën këmbët e nënës!"[10], duke e lartësuar kështu figurën e gruas dhe duke i dhënë asaj pozitën e merituar. Në një tjetër hadith profetik thuhet se: "Jeta e kësaj botë është një mirësi kalimtare. Mirësia më e madhe e kësaj bote është gruaja e devotshme dhe e mirë." *(Muslim, Rida'a, 64; Nesai, 15; Ibn Maxhe, Nikah, 5)*

Më janë bërë të dashura nga kjo botë gruaja e mirë dhe era e miskut, ndërsa namazi është drita e syve të mi. *(Nesai, Isharetu'n-Nisa, 10; Ahmed, III, 128,199)*

Nuk duhet lëmë pa përmendur se, gruaja e cila është kurorëzuar me disa martesa në këtë botë, në Ahiret, ajo do të martohen me më të devotshmin e burrave të saj.

KARAKTERISTIKAT E MIRËSIVE TË XHENETIT

Mirësitë e Xhenetet nuk do jepen për të kompensuar apo për të shpërblyer një vështirësi apo shqetësim të robit besimtar. Po ashtu, as ushqimi dhe pijet nuk do jenë për të shuar urinë apo etjen. Në të njëjtën mënyrë, edhe përdorimi i aromës së mirë nuk do jetë një domosdoshmëri për t'u mbrojtuar nga aroma e keqe. Përkundrazi, të gjitha këto janë mirësi dhe kënaqësi që do vijnë pa ndërprerje. Krijuesi Fuqiplotë thotë: "Këtu nuk do të mbetesh kurrë as i uritur e as i zhveshur, dhe nuk do të kesh as etje, as vapë." (Kur'ani, *TaHa, 118-119)*[11]

I Dërguari i Allahut thotë: "Banorët e Xhenetit janë të përhershëm mes mirësive dhe bagative, por to nuk ka mërzi dhe brengë, rrobat e tyre nuk vjetërohen kurrë dhe rinia nuk u konsumohet." *(Muslim, Xhenet, 22)*

"Një lajmëtar do të thërrasë: Ju do të qëndroni në Xhenet të shëndetshëm, nuk do të sëmureni asnjëherë. Do të jetoni përgjithmonë dhe nuk do vdisni kurrë. Do të qëndroni përherë të rinj, nuk do të plakeni kurrë. Do jetoni mes mirësisë dhe lumturisë, nuk do keni asnjë mërzi dhe brengë."

Kjo e vërtetë tregohet edhe në ajetin kuranor: "Ne do ta shkulim urrejtjen nga kraharori i tyre. Te këmbët e tyre do të rrjedhin lumenj dhe ata do të thonë: "Qoftë lavdëruar Allahu që na udhëzoi në këtë. Ne nuk do të ishim udhëzuar, sikur të mos na udhëzonte Allahu. Pa dyshim, të dërguarit e Zotit tonë kanë sjellë të vërtetën". Dhe një zë do t'i thërrasë: "Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar". *(Kur'ani, Araf, 43) (Muslim, Xhenet, 22)*[12]

LUMENJTË E XHENETIT

Krijuesi Fuqiplotë thotë: "Ja përshkrimi i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre. A mund të krahasohet ky shembull me Xhehenemin, ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i valuar, që ua copton zorrët?!" *(Kur'ani, Muhamed, 15)*

I Dërguari i Allahut ka thënë: "Në Xhenet ka detë uji, det mjalti, det qumështi dhe detë vere prej të cilëve gufojnë lumenj." *(Tirmidhi, Xhenet, 27/2571)*

Mirëpo nuk duhet të harrojmë se vera e Xhenetit nuk është e njëjtë me verën e dynjasë.

Krijuesi Fuqiplotë e përshkruan atë si më poshtë: "Aty do t'u shërbehet një gotë e mbushur nga një burimi i rrjedhshëm, (me pije) të bardhë e të shijshme për ata që do ta pinë. Prej saj as nuk do të trullosen dhe as nuk do të dehen. Pranë tyre do të jenë gra me shikim të ulur e sy të bukur sikur të ishin vezë të ruajtura mirë." *(Kur'ani, Safat, 45-49)*

ÇFARË ËSHTË BURIMI I KEUTHERIT?

Një ditë të Dërguarin e Allahut e pyetën se ç'ishte burimi i Keutherit dhe ai u përgjigj: "Ai është një burim që do të më jepet mua në Xhenet. Uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Rreth tij ka disa zogj qafa e të cilëve ngjan me qafën e devesë."

Pas kësaj hz. Omeri tha: "Këta duhet të jenë mirësi ushqyese dhe të mira."

I Dërguari i Allahut tha: "Banorët e Xhenetit (që i konsumojnë këta mirësi) janë edhe më të bukur dhe më të mirë!" *(Tirmidhi, Xhenet,10/2542)*

SI PËRSHKRUHET XHENETI?

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) e përshkruan me fjalët e mëposhtme bukurinë dhe përsosmërinë e Xhenetit: "...Një vend në Xhenet sa hapësira midis harkut ose sa hapësira ku vendos këmbën është më i vlefshëm se krejt bota dhe gjithçka ka në të. Nëse gruaja e Xhenetit do kishte hedhur një vështrim në tokë, kjo do mjaftonte për të ndriçuar hapësirën midis tokës dhe qiellit dhe do ta mbushte atë me aromë misku. Pa dyshim se mbulesa e asaj gruaje është më e vlefshme se krejt bota dhe gjithçka ka në të." *(Buhari, Rikak, 51)*

"Nëse në botë do shfaqej një pjesë aq e vogël e begative të Xhenetit sa mund të mbajnte thoi, horizontet midis qiejve dhe tokës do zbukuroheshin dhe pasuroheshin. Nëse një banor i Xhenetit do hidhte shikimin në tokë dhe një nga byzylyket e tij do shfaqeshin në të, kjo do mjaftonte për të zhdukur dritën e diellit ashtu sikurse dielli zhduk dritën e yjeve." *(Tirmidhi, Xhenet, 7/2538)*

Enesi (r.a.) tregon: Pjegmberit a.s. iu dhurua (nga Ukejdiri) një veshje prej atllasi të hollë. I Dërguari i Allahut e pati ndaluar mëndafshin për burrat. Por njerëzit përreth u mahnitën nga bukuria dhe butësia e rrobës dhe e pëlqyen atë shumë. I Dërguari i Allahut tha: "Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit, shamitë e Sad bin Muadhit në Xhenet janë shumë më të bukura sesa kjo!" *(Buhariu)*

Një person erdhi tek Profeti a.s. dhe e pyeti: A flenë banorët e Xhenetit?

I Dërguari i Allahut u përgjigj: Gjumi është vëllau i vdekjes, banorët e Xhenetit nuk vdesin kurrë! *(Bejhaki, Shuab, VI, 409/4416; Hajsemi, X, 415)*

Siç dihet, në kushtet e kësaj bote, para pasqyrës njërzit dita ditës dëshmojnë plakjen e tyre të ngadaltë, por të vazhdueshme. Mirëpo në Xhenet një realitet i tillë nuk do ekzistojë, përkundrazi banorët e Xhenetit çdo ditë e më tepër do zbukurohen.[13] I Dërguari i Allahut e ka shprehur këtë të vërtetë me fjalët e mëposhtme: "Në xhenet ndodhet një treg ku banorët e saj e viztojnë çdo të Xhuma. Aty, një erë veriu fryn aromën e Xhenetit në fytyrat dhe rrobat e tyre duke ua shtuar bukurinë edhe më shumë. Kur ata kthehen në shtëpitë e tyre anëtarët e familjes u thonë: Pasi u ndatë nga ne bukuria juaj qenka shtuar edhe më shumë!

Edhe ata përgjigjen: Po ashtu, edhe ju qenkeni zbukuruar dhe hijeshuar edhe më shumë!" *(Muslim, Xhenet,13)*

MIRËSIA E QË DO I JEPET NJERIUT TË FUNDIT QË DO HYJË NË XHENET

I Dërguari i Allahut i tregon me fjalët e mëposhtme mirësitë që do i falen banorit të fundit të Xhenetit: "Unë njoh personin e fundit që do dalë nga Xhehenemi dhe do hyjë në Xhenet. Ky person del nga Xhehenemi duke u zvarritur. Krijuesi Fuqiplotë thotë:

"-Shko, hyr në Xhenet! "

Personi afrohet në Xhenet por atij i tregohet sikur të jetë i mbushur plot. Kthehet dhe thotë:

"-O Zot, Xheneti është i mbushur (nuk gjeta vend)!"

Krijuesi Fuqiplotë thotë përsëri:

"-Shko, hyr në Xhenet! "

Personi afrohet përsëri në Xhenet por atij përsëri i tregohet sikur të ishte i mbushur plot. Kthehet dhe thotë:

"-O Zot, Xheneti është i mbushur (nuk gjeta vend)! "

Këtë herë Krijuesi Fuqiplotë thotë:

"-Shko, hyr në Xhenet! Aty ka vend për ty sa krejt bota dhe dhjetë herë bota. " Ose vetëm:

"-Aty ka vend për ty sa krejt bota! "

Personi thotë:

"-O Zot! A po tallesh me mua edhe pse je Sundimtari i vetëm?" Ose vetëm:"- A po qesh me mua?"

Transmetuesi i këtij hadithi tregon: Kur i Dërguari i Allahut na tregoi për këtë dialog buzëqeshi aq shumë saqë arrita t'i shikoj edhe dhëmbët. Sahabët tregonin për këtë rast si "personi që është në gradën më të ulët të Xhenetit." (Buhari, Rikak, 51)

Çdo banor i Xhenetit do jetë sundues i pronës së tij. Krijuesi Fuqiplotë do i dhurojë banorëve të Xhenetit sundim dhe mbretërim shumë herë më tepër se mbretërve të botës.[14]

Në ajetin fisnik thuhet: "Ngado që të hedhësh sytë, do të shohësh lumni dhe një mbretëri të madhe." *(Insan, 20)*

Nëse personit që ndodhet në gradën më të ulët të Xhenetit do i dhurohet një mirësi kaq e madhe, lind pyetja, po atyre që do jenë në shkallët më të larta të Xhenetit, çfarë do u dhurohet?! Siç dihet Xheneti ka gradë shumë të larta. Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: "Në Xhenet ka 100 shkallë të cilat Krijuesi Fuqiplotë i ka krijuar për ata të cilët luftojnë në rrugën e Tij. Largësia midis çdo shkalle është sa hapësira midis tokës dhe qiellit. Kur t'i luteni Allahut lutjuni për Xhenetin Firdeus! Sepse ai është mesi i Xhenetit dhe shkalla më e lartë e tij." *(Buhariu)*[15]

Përktheu dhe përshtati:

Elona SYTARI

(Osman Nuri Topbaş ef., Ebediyet Yolculuğu)

1. Kur'ani, Err-Rrahman: 72.
2. Kur'ani, El-Bakare: 25, Ali Imran: 15, En-Nisa: 57.
3. Buhariu.
4. Tirmidhiu.
5. Kem/i: temjan, rrëshirë që nxirret nga disa bimë dhe që lëshon erë të mirë kur digjet.
6. Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.
7. Dhira: parakrah.
8. Buhariu dhe Muslimi.
9. Muslimi.
10. Nesaiu dhe Imam Ahmedi.
11. Kurtubi, Tedhkire, s. 984.
12. Tirmidhiu.
13. Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 35/34005; Muslim, Xhenet, 13.
14. Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Kurtubiu.
15. Nesaiu dhe Imam Ahmedi.

SUREJA EL-KEHF DHE MËSIMET E SAJ (2)

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

VLERA E LEXIMIT TË SURES EL-KEHF

1. Ebu Seid El-Hudrij (r.a) transmeton se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e lexon suren Kehf natën e xhuma, i bëhet dritë (në një distancë) prej tij deri në Qabe".[1]

2. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e lexon suren Kehf ditën e xhuma, i bëhet dritë atij ndërmjet dy xhumave."[2]

3. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush e lexon suren Kehf ditën e xhuma, e mbulon drita prej këmbëve e deri në qiell, dritë që do të ndriçojë në Ditën e Gjykimit."[3] Për sa u përket transmetimeve të lartpërmendura, dijetarët janë ndarë në mendime të ndryshme në lidhje me vërtetësinë e këtyre haditheve.

Çfarë nënkuptohet me fjalën "dritë" në këto hadithe?

Dijetarët e islamit lidhur me fjalën "dritë" kanë dhënë disa interpretime:

a). Ambienti jo i mirë, haramet, fitnet etj i sjellin njeriut errësirë. Kjo sure me mësimet dhe porositë e saj na bën dritë dhe na shpëton që të mos jemi viktimë e errësirës që sjell ambienti ku ne jetojmë.

b). Allahu i jep njeriut dritë domethënë e udhëzon, e drejton dhe e ruan atë nga të këqijat (haramet).

c). Kjo dritë, njeriut në ditën e kijametit (në atë ditë të errët) do ja ndriçojë rrugën për në xhenet.

4. Transmetohet nga Bera ibn Azib (r.a) i cili ka thënë: "Një njeri (sahab) po lexonte suren "Kehf", ndërkohë që kali që kishte pranë filloi të trembej. Shikoi përreth dhe pa një re e cila e kishte mbuluar atë. Në mengjes kur ia tregoi këtë gjë të Dërguarit të Allahut, Pejgamberi (a.s) i kishte thënë: "Ajo (re) ka zbritur për shkak të Kuranit (që ke lexuar) si prehje, qetësi".[4]

5. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush i mëson përmendësh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të mbrohet nga sprovat e Dexhalit".[5]

Përse 10 ajetet e para të kësaj sureje janë mburojë prej dexhalit cila është urtësia?

Sepse këto ajete përfundojnë me një dua dhe sekreti i mbrojtjes është kjo lutje.

"O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!"[6] Gjithashtu në këto ajete përcjelljet mesazhi i duasë atëherë kur ballafaqohemi me problematika në jetën tonë të përditshme. Duaja është qetësim dhe zgjedhje e problemeve.

U pyet njëri nga gjeneratat e para: A njeh dikë që lutjen e ka të pranuar tek Allahu? Tha: Jo, mirëpo e njoh Atë që i pranon lutjet.

KOHA E LEXIMIT TË SURES KEHF.

Koha në të cilën mundet të lexosh suren el-Kehf fillon me perëndimin e diellit në ditën e Enjte deri në perëndim të diellit ditën e Xhuma, sepse transmetimet që flasin për këtë temë kanë ardhur edhe për natën e ditës së Xhuma edhe për ditën e Xhuma.[7]

Imam Shafiu (Allahu e mëshiroftë) ka thënë: "E dua leximin e sures El-Kehf natën e xhuma, apo ditën e saj, për shkak të atyre citateve profetike të përcjella në lidhje me të".

Edhe leximi i sures El-Kehf në ditën e xhuma duhet të ketë ardhur për shkak te përmbajtjes së saj, sepse ajo si temë kryesore në përmbajtjen e saj ka qëndresën e rrallë të disa besimtarëve të hershëm në besimin e tyre, të cilët Allahu i madhëruar i bëri shembull të mirë për mbarë njerëzimin me përkrahjen dhe ndihmën e çuditshme që patën prej Tij.

Ajo gjithashtu përshkruan edhe disa ngjarje të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me veçoritë e xhumasë si: historia e Ademit (a.s) me Iblisin, ora e fundit e dynjasë dhe disa shenja të afrimit të saj, kiameti dhe tmerret e tij, sepse këto ngjarje siç jemi njoftuar, ose kanë ndodhur ditën e xhuma, ose do të ndodhin në këtë ditë.

Në suren Kehf përmenden katër histori. E përbashkëta mes këtyre historive është se ato përmbajnë katër fitne (sprova) të cilat i hasim në jetën tonë të përditshme.

Sprova e parë është ajo e fesë, ku dikush mund të dalë nga feja, adhurimi i Zotit dhe përkushtimi ndaj Tij. Sprovën e fesë e gjejmë të konkretizuar tek djelmoshat e rinj të cilët u izoluan për qindra vite në shpellë.

Çfarë i bëri banorët e shpellës që të kishin kujdesin e Allahut/ Përse Allahu u kujdes për to?

1. Besimi i pastër në Zotin (Teuhidi). Allahu i madhëruar thotë: "Ne i forcuam zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: "Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe".[8]

Banorët e shpellës e kishin shumë të kristalizuar çështjen e besimit. (E njohën Allahun siç duhet). Kur përmendet besimi i tyre në Kuran (pavarësisht që përmendet krejt shkurt në dy-tre ajete) [9] tregohet se ata besimin e tyre nuk e përdoren për të luftuar, për të debatuar dhe për të nënçmuar të tjerët por e përdoren atë për dy çështje kryesore. Ato kishin:

- Dhembshuri për popullin e tyre përse ata nuk janë të udhëzuar.

- Imunitet që të ruhen nga dilemat e kohës.

2. Besimi i fortë. Allahu i madhëruar thotë: "Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre".[10] Ishin të rinj, por ishin të vendosur dhe me besim të fortë.

3. Shoqëria e mirë. Ai që dëshiron që të ruhet e të ketë kujdesin e Allahut dhe të jetë i strehuar nga sprovat e ndryshme duhet që të shoqërohet me njerëz të mirë.

Këto djelmosha ishin të lidhur fortë me njëri-tjetrin. Ata dolën së bashku, u strehuan së bashku dhe kur u zgjuan ishin të organizuar. Ata thanë: njëri nga ne duhet të shkojë në qytet për të marrë ushqim dhe u caktua që të shkonte njëri prej tyre. Kujdesi dhe mëshira e Allahut vjen atëherë kur jemi të bashkuar, të vëllazëruar dhe të organizuar siç duhet. Allahu i Madhëruar thotë: "Dhe qëndro me ata që i luten Zotit të vet në mëngjes dhe mbrëmje, duke dëshiruar Fytyrën (kënaqësinë) e Tij dhe mos i shmang sytë nga ata (tek të tjerët), duke dëshiruar stolitë e shkëlqimin e kësaj jete".[11] Transmeton Ebu Hurejra (r.a) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj secili nga ju të bëjë kujdes se me ke shoqërohet."[12]

4. Konsultimi (Vendimmarrje me konsultim). Fatkeqësisht shumë nga ne sot ose marrim vendimet të mënjëhershme ose të gabuara ose të vonuara. Edhe pse Muhamedi (a.s) ishte një udhëheqës me shpallje Allahu i madhëruar i tha: "Këshillohu (Konsultohu) me ata për çështje të ndryshme".[13]

Ebu Hurejra (r.a) thotë: "Nuk kam parë dikë që konsultohej më shumë me shokët e tij, sesa Pejgamberi (a.s). Si shembull për këtë është konsultimi i tij në Betejën e Bedrit, kur thotë:"Më propozoni (jepni mendimet tuaja) o ju njerëz!". Po ashtu kur u konsultua për robërit e luftës tha: "Çfarë mendimi keni për këta robër lufte?"

Omer bin Abdulazizi (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: "Konsultimi dhe dialogu janë derë e mëshirës dhe çelës i bereqetit...". Djelmoshat e shpellës u konsultuan me njëri-tjetrin se çfarë të bënin. Kur duhej për tu larguar u larguan. U konsultuan me njër-tjetrin që të strehohen tek njerëzit apo në shpellë dhe vendosen që të strehohen në shpellë. Neve sot na mungon analizimi i gjërave për të marrë vendime të duhura.

5. Mbështetja në Allahun. Ata djelmosha ishin të rinj pa përvojë të madhe por kur ata u mbështetën në Allahun e madhëruar dhe i moren hapat e duhur, Allahu i ndihmoi ata dhe i bëri shembull për gjithë njerëzimin deri ditën e gjykimit.

Ahmed ibn Hanbel (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: "Teuekul-i është t'ia dorëzosh çështjet Allahut dhe besimi në Të." Aliu (r.a) ka thënë: "O ju njerëz, mbështetuni në Allahun dhe besoni në Atë, sepse Ai ju mjafton." "Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij."[14]

Sprova e dytë është ajo e pasurisë, të cilën e gjejmë të konkretizuar tek pronari i vreshtës. Ai u mashtrua nga pasuria që kishte dhe u largua nga rruga e Zotit.

Sprova e tretë është ajo e diturisë. Shumë njerëz mund të përftojnë dije të shumta, por që nuk janë të dobishme, u pëlqen vetja, i largon nga rruga e Zotit etj...

Sprova e katërt dhe e fundit është ajo e pushtetit, të cilën e shohim të mishëruar në historinë e Dhul Karnejnit. Faktori stimulues i këtyre katër sprovave, përmendet direkt pas dy historive të para. Ai është pikërisht shejtani i mallkuar. Historinë e tij me Ademin (a.s) Zoti e përmend shkurtimisht vetëm pasi ka përmendur dy historitë e para. Pasi Zoti përmend mashtrimin e shejtanit që i bëri Ademit (a.s) u drejtohet njerëzve: "Atëherë, a do ta merrnit atë dhe pasardhësit e tij për mbrojtës në vendin Tim, edhe pse ata janë armiqtë tuaj?! Sa këmbim i shëmtuar që është ky për keqbërësit!"[15]

Po të shohim me kujdes, do të vërejmë që ajetet e fundit të sures Kehf, flasin mbi ruajtjen nga të gjithë fitnet dhe sprovat e kësaj bote. Allahu i madhëruar thotë: "Kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!"[16]

Nëse kërkon të ruhesh nga të gjithë llojet e sprovave dhe fitneve, vepro punë të mira dhe shoqëroji ato me sinqeritet të plotë. Dijetarët e islamit kanë thënë: "Kushtet e pranimit të një vepre janë dy: I pari të jetë vepër e mirë dhe i dyti të veprohet me sinqeritet dhe vetëm për hatër të Zotit".

Allahu (xh.sh) në këtë sure na orienton për disa shprehje:

1. Shprehja Inshallah. Allahu (xh.sh) thotë: "Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: "Me siguri që nesër do ta bëj këtë", pa shtuar "Në dashtë Allahu!" Dhe, kur të harrosh (të thuash"në dashtë Allahu") kujtoje Zotin tënd e thuaj (Do të thotë: kujtoje urdhrin e Zotit tënd për të thënë inshallah); "Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo".[17] Në këtë sure Allahu i thotë Profetit (a.s) mos thuaj se do të bëjë nesër kështu përveçse duke thënë inshallah në dashtë Allahu. Kjo fjalë është një lloj mbështetje dhe dorëzimi tek Allahu (xh.sh).

Thuhet se Kurejshët i pyetën jahuditë e Medinës duke u thënë: Tek ne ka dalur një njeri, i cili pretendon se është i dërguari i Zotit, si është kjo punë? Ata i'u përgjigjen: Pyeteni atë për tri gjëra. Nëse ju përgjigjet, atëherë dijeni se ai është i dërguar i Allahut. Pyeteni atë:

- Për djemtë që lanë qytetin e tyre dhe u strehuan në një shpellë.

- Për një burrë që sundoi lindjen dhe perëndimin.

- Për shpirtin.

Pasi kurejshët ia bënë këto pyetje të Dërguarit të Allahut (a.s). Ai u tha se do t'ju përgjigjet të nesërmen, e nuk tha inshallah (në dashtë Allahu). Pas kësaj shpallja u ndërpre për rreth pesëmbëdhjetë ditë. Pejgamberi (a.s) na ka treguar edhe rastin e Sulejmanit (a.s) i cili ka thënë: "Sonte do të fle me shtatëdhjetë gra (nga gratë e tij), (sipas një transmetimi tjetër me nëntëdhjetë gra, dhe sipas një transmetimi tjetër me njëqind gra), ku secila do më lindë nga një djalë që do luftojë në rrugën e Allahut." Por nuk tha: inshallah "Në dashtë Zoti." Ai fjeti me to, por vetëm njëra prej tyre mbeti shtatzënë dhe ajo lindi një gjysmë fëmijë (pa duar dhe këmbë). Pejgamberi (a.s) thotë: Betohem në Atë që ka shpirtin tim në dorë, sikur Sulejmani (a.s) të kishte thënë "Në dashtë Allahu" do ta arrinte atë që e dëshironte."[18]

Allahu (xh.sh) thotë: "Ne e vumë në provë Sulejmanin dhe vendosëm në fronin e tij një trup, (një fëmijë pa duar dhe këmbë) por ai iu drejtua Zotit."[19] Allahu i madhëruar dëshironte t'i tregonte robërve të Tij se çështja është në Dorë të Tij dhe se njeriu sado gradë të lartë të arrijë, nuk bën dot pa ndihmën e Allahut.

Kur dikush thotë inshallah (në dashtë Allahu) për diçka që ai do ta bëjë, ka dy dobi:

- Allahu ia lehtëson çështjen robit kur ai e lë çështjen në Dorë të Tij.

- Nëse ajo gjë nuk veprohet nuk ka shlyerje për të.

2. Shprehja. Kur njeriu mahnitet ose gëzohet me një të mirë që i ka dhënë Allahu. (Fëmijë, pasuri, shëndet, shtëpi, sukseset e tij... etj). Duhet të thotë: "Mashallah la kuvvete illa billah", "Kështu ka dashur Allahu! Nuk ka fuqi përveçse nëpërmjet Allahut."[20] Njeriu kur shikon diçka që e mahnit te pasuria e tij, duhet të thotë: "Mashallah la kuvvete illa billah" (Kështu ka dashur Allahu! Nuk ka fuqi përveçse nëpërmjet Allahut), me qëllim që çështjen ta lërë në Dorë të Allahut dhe jo në të tijën. Në hadith thuhet se kush thotë këtë shprehje në kohën që diçka e mahnit te pasuria e tij, atëherë nuk i ndodh asgjë e keqe në të.

Këto dy shprehje besimtari i përdorë edhe si shenjë falënderimi por edhe si pastrim prej mendjemadhësisë dhe xhelozisë.

1. Transmetuar nga Darimiu.
2. Transmetuar nga Hakimi dhe Bejhekiu.
3. Transmetuar nga Hakimi.
4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi. Ndërsa njeriu i cili e kishte lexuar këtë sure quhej Usejd ibn el-Hudajri.
5. Transmetuar nga Ahmedi.
6. Kur'ani, El-Kehf: 10.
7. Shih: "Fejdul-Kadir", 6/198-199.
8. Kur'ani, El-Kehf: 14.
9. Kur'ani, El-Kehf: 13-15.
10. Kur'ani, El-Kehf: 13.
11. Kur'ani, El-Kehf: 28.
12. Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.
13. Kur'ani, Ali Imran: 159.
14. Kur'ani, Et-Talak: 3.
15. Kur'ani, El-Kehf: 50.
16. Kur'ani, El-Kehf: 110.
17. Kur'ani, El-Kehf: 23-24.
18. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.
19. Kur'ani, Sad: 34.
20. Kur'ani, El-Kehf: 39.

MYFTIU PRITI MENDIMTARIN ISLAM, DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO

Paraditën e së xhumasë, më 18 tetor 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt mendimtarin e shquar islam damasken, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për kontributin e pashembullt që ka dhënë Fondacioni "Shejkh Ahmed Keftaro" në Damask të Sirisë, si qendra më e madhe islame në Lindjen e Mesme, ku kanë marrë edukim elitar me mijëra thirrës islamë nga mbarë bota.

Myftiu tha se Siria ishte dhe mbeti djep i civilizimeve, prag i qytetërimeve të mëdha dhe vendi i madh i dijetarëve më të spikatur të botës islame në shekuj.

Nga ana e tij, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro, falënderoi Myftiun për mikpritjen dhe shprehu kënaqësinë e tij për këtë prani në Shkodër, si një djep i bashkëjetesës në mesin e besimeve dhe kulturave, sikurse vlerësoi kontributin e Myftiut Sytari dhe institucionit që ai drejton në ruajtjen dhe përhapjen e frymës së harmonisë ndërfetare,

edukimin e brezit të ri me udhëzimin islam dhe përhapjen me krenari të mësimeve islame në Shkodrën e dijes dhe dijetarëve.

Gjatë këtij takimi, Myftiu e informoi mikun e shtrenjtë mbi historikun e Islamit në Shkodër dhe mbi disa botime të Myftinisë Shkodër.

DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO: "SHKODRA, SHEMBULL I BASHKËJETESËS NDËRFETARE!"

Ditën e xhuma, më 18 tetor 2019, nga xhamia e Parrucës, mendimtari i shquar islam nga Damasku, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro, shprehu mirënjohjen dhe falënderimet e tij për Myftiun dhe Myftininë e Shkodrës për ftesën bujare për të ligjëruar në mesin e besimtarëve të shumtë në ditën e begatë të xhumasë.

Dr. Keftaro dha disa mesazhe me vlerë për besimtarët e kryeqendrës së Veriut, ku fillimisht shprehu mirënjohjen e tij në drejtim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Ilir Meta, për pritjen e përzemërt dhe bashkëbisedimin plot vlerë.

Njëkohësisht, ai tha se Siria kaloi një periudhë të vështirë dhe një sprovë të madhe, që tashmë është kapërcyer dhe djepi i qytetërimeve të mëdha botërore i shpëtoi copëtimit.

Ai vlerësoi gjurmët e bashkëjetesës ndërfetare në Shkodër e Shqipëri, ku tha se, njësoj si në Siri e Damask, edhe në Shqipëri e Shkodër, prania e

kishës bri xhamisë mbetet përherë një thirrje dhe nxitje drejt harmonisë dhe bashkëjetesës në paqe.

Dr. Salahudin Ahmed Keftaro tha se kohëve të fundit Islami dhe muslimanët janë etiketuar me cilësime të pavërteta e të padrejta, por sikurse thotë edhe fjala e urtë: "Njeriu është armik i asaj që injoron". Prandaj, lypset që secili prej nesh ta prezantojë sa më mirë Islamin, si një fé e paqes dhe e bashkëpunimit në mesin e njerëzve.

DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO, SEMINAR ME IMAMËT DHE THIRRËSIT E SHKODRËS

Sikurse edhe ishte lajmëruar më parë, ditën e shtunë, më 19 tetor 2019, Myftinia Shkodër organizoi seminarin me temë: "Thirrësi islam, garanci e sigurisë dhe paqes në shoqëri", ku i ftuar special ishte mendimtari i shquar islam damasken, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro.

Të pranishëm në këtë seminar ishin imamë, teologë, vaizë e vaize nga Shkodra, Malësia e Madhe, Tetova dhe Tirana, që me interesim të madh ndoqën këshillat e dobishme të ligjëruesit të mirënjohur, personalitetit të shquar islam nga Damasku, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro.

Gjatë këtij aktiviteti me vlerë u vu theksi te nevoja e bashkimit të energjive për të punuar me të gjitha forcat dhe mundësitë tona për përhapjen e Islamit të pastër, të zhveshur nga çdo tendencë përçarëse dhe përpjekje për të ndaluar bashkimin e përvojave, aftësitë dhe

mundësitë e bashkëpunimit, si një dirë e vetme, siç urdhëron Kur'ani dhe Hz. Muhanmedi (a.s.).

Dr. Keftaro theksoi se Islami sot, paragjykohet dhe etiketohet ndryshe nga ç'është në të vërtetë. Për këtë lypset që thirrësit islamë të zhveshin mëngët për të bërë më të mirën e mundshme që bota të njohë të vërtetën e kësaj feje të madhnueshme islame; fe e shekullit 21.

DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO, KËSHILLA TË URTA DREJTUAR RINISË DHE FEMRËS MUSLIMANE

Paraditën e së dielës, më 20 tetor 2019, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet me dobi, ku Dr. Salahudin Ahmed Keftaro ligjëroi përpara një auditori të përzgjedhur me të rinj e të reja muslimanë të Shkodrës.

Në qendër të këtij takimi ishin këshillat e urta, me të cilat, Dr. Keftaro iu drejtua të pranishmëve, duke i ftuar që ta jetojnë fenë e tyre me krenari legjitime dhe të zgjohen nga realitetet e zymta, në të cilat Islami akuzohet për terrorizëm e ekstremizëm, duke e paraqitur fenë në realitetet e jetuara, me mëshirë, dije e moral.

Ai tha se Islami e ka nderuar femrën dhe e ka ngritur lart pozitën e saj dhe

se, femra muslimane duhet të lexojë si duhet ajetet e sureve që lidhen të drejtat dhe pozitën e saj, për të kuptuar se në Islam ajo është nënë e nderuar, motër e mbrojtur, bijë fisnike, bashkëshorte edukatore. Aktiviteti u përshëndet edhe nga myftilerët e nderuar, Imam Muhamed B. Sytari dhe H. Edmir Smajlaj.

DR. SALAHUDIN AHMED KEFTARO BASHKËBISEDOI ME MATURANTËT E MEDRESESË

Ditën e hënë, më 21 tetor 2019, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro, i shoqëruar edhe nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një vizitë në Medresenë "Haxhi Sheh Shamia", ku u prit nga drejtori, z. Kujtim Dervishi me stafin e tij.

Gjatë kësaj vizite, drejtori i Medresesë e informoi mikun e madh nga Siria mbi historikun, arritjet dhe rezultatet përherë në rritje të Medresesë, si një djep i sigurtë i dijes, besimit dhe qytetarisë.

Nga ana e tij, Dr. Keftaro vlerësoi arritjet e Medresesë së Shkodrës me dy degët e saj, sikurse dha disa udhëzime

dhe këshilla me dobi për vazhdimësinë e aktivitetit dhe larminë e tij. Më pas, ai zhvilloi edhe një bashkëbisedim të hapur me maturantët e shkollës, ku dha këshillat e tij të vyera për të pranishmit.

Më herët, aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i theksoi se është në nderin e Myftinisë Shkodër që të ketë mik të madh e të shtrenjtë në Shkodër, personalitetin e shquar islam Dr. Salahudin Keftaro.

Aktiviteti u shoqërua edhe me pyetje të shumta, që maturantët ia drejtuan mendimtarit dhe thirrësit të shquar nga Damasku.

BAGDADI DHE EPOKA E ARTË E ISLAMIT

BAGDADI, KRYEQYTETI I DINASTISË ABASITE, ISHTE BËRË KRYEQENDRA BOTËRORE E DITURISË DHE E TREGTISË.

Pasi në Bagdad u themelua "Shtëpia e Urtësisë", dijetarët e botës Islame iu vunë punës për mbledhjen e njohurive të trashëguara të botës antike, dhe përkthimin e kësaj trashëgimie në gjuhën arabe. Kjo lëvizje do të ishte pikënisja e një epoke të re për Botën Islame, një epokë që do të njihej si "Epoka e Artë e Islamit". Kjo epokë do të fillonte që nga mesi i shekullit të 7-të, e do të vazhdonte deri në mesin e shekullit të 13-të. Gjatë kësaj periudhe, dijetarët e botës Islame kontribuuan në mënyrë të konsiderueshme në fushën e artit, letërsisë, filozofisë, shkencave të ndryshme, mjekësisë, navigacionit, bujqësisë, ekonomisë, industrisë dhe teknologjisë. Arritjet e tyre u realizuan duke u mbështetur në njohuritë e trashëguara nga antikiteti, dhe duke i zhvilluar edhe më tej ato, nëpërmjet shpikjeve dhe risive që ata sollën.

Sipas historianëve, nga mesi i shekullit të 9-të, Shtëpia e Urtësisë kishte numrin më të madh të librave në botë. Me fjalë të tjera, të gjitha njohuritë e botës antike, u konsoliduan në një vend, dhe në një gjuhë. Arabishtja ishte bërë tashmë gjuha zyrtare e shkencës dhe e zhvillimit.

Në këtë periudhë, për herë të parë ishte futur në përdorim letra, sekreti i prodhimit të së cilës mbahej i fshehtë nga kinezët, por që u mësua nga robërit e luftës, të zënë në Betejën e Talasit (751). Teknika e prodhimi të letrës u përmirësua edhe më tej nga arabët. Në Bagdad do të gjeje qindra dyqane që punësonin shkrues dhe lidhës librash. Filluan të themelohen edhe bibliotekat publike.

Në Bagdad u themeluan një sërë institucionesh të rëndësishme arsimore dhe shkencore, të cilat nuk ishin të njohura më parë në botën antike. Nga ato institucione, nga më të njohurat ishin biblioteka publike dhe biblioteka që jepte libra hua, universiteti akademik që jepte diploma, observatori astronomik si një institucion kërkimi dhe jo një qendër e thjeshtë vëzhgimi si në kohërat antike, spitali i përgjithshëm (i cili zëvendësoi tempujt e shërimit) dhe spitali psikiatrik.

Tani Bagdadi, kryeqyteti i dinastisë Abasite, ishte bërë kryeqendra botërore e diturisë dhe e tregtisë.

FRYMA KULTURORE

Shumë mendimtarë myslimanë të asaj kohe ndoqën ligjërime humaniste, racionale dhe shkencore, në kërkimin e tyre për njohuri dhe vlera. Liria fetare që garantonte Islami, ndihmoi në krijimin e rrjeteve ndër-kulturore mes intelektualëve myslimanë, të krishterë dhe hebrenj. Të ndriçuar nga mësimet e Kur'anit Famëlartë dhe të Traditës së ndritur Profetike, në shoqërinë islame respektohej liria e fjalës.

Bota islame asokohe pati shkallën më të lartë të shkrim-leximit, në krahasim me shoqëritë e tjera para-moderne.

Faktorë të tjerë mjaft të rëndësishëm për përhapjen e arsimimit ishin edhe interesimi i madh i shoqërisë për mësimin përmendësh të Kur'anit Famëlartë, studimin e imtësishëm të tij, dhe shfaqja e institucioneve tilla si Mektebet dhe Medresetë, ku mësoheshin e studioheshin fusha të ndryshme të diturisë.

ARSIMIMI

Bota islame asokohe pati shkallën më të lartë të shkrim-leximit, në krahasim me shoqëritë e tjera para-moderne. Një faktor për nivelet e larta të shkrim-leximit ishte interesimi i madh i prindërve për arsimimin e fëmijëve të tyre. Përhapja në masë e përdorimit të letrës, çoi në lulëzimin e industrisë së librit dhe të kulturës së shkruar, në shoqërinë Islame. Përveç përdorimit të gjerë të librave të shkruar në letra, në shoqërinë islame, më shumë se në çdo shoqëri tjetër ekzistuese më parë, faktorë të tjerë mjaft të rëndësishëm për përhapjen e arsimimit ishin edhe interesimi i madh i shoqërisë për mësimin përmendësh të Kur'anit Famëlartë dhe studimin e imtësishëm të tij, dhe shfaqja e institucioneve tilla si Mektebet dhe Medresetë, ku mësoheshin e studioheshin fusha të ndryshme të diturisë.

EKONOMIA

Gjatë Epokës së Artë Islame, Perandoria Islame kontribuoi ndjeshëm në globalizim, atëherë kur njohuritë, tregtia dhe ekonomitë e shumë rajoneve dhe civilizime të izoluara më parë, filluan të integrohen përmes kontakteve me eksploruesit dhe tregtarët myslimanë dhe arabë. Rrjetet tregtare u shtrinë nga Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe në perëndim, deri në Oqeanin Indian dhe Detin e Kinës në lindje. Këto rrjete tregtare ndihmuan që përgjatë shekujve 7-13, Perandoria Islame të bëhej fuqia kryesore ekonomike në botë.

EKONOMIA E TREGUT

Format e hershme të proto-kapitalizmit dhe tregjet e lira, ishin të pranishme në kohën e Perandorisë Islame, ku një ekonomi e hershme tregu dhe një formë e hershme e kapitalizmit tregtar u zhvilluan ndërmjet shekujve 8-12, dukuri së cilës disa i referohen si "kapitalizmi islamik". U krijua një ekonomi e fuqishme monetare, në bazë të një monedhe të përbashkët të qarkulluar gjerësisht (dinarit), dhe të integrimit të zonave monetare, të cilat më parë ishin të pavarura. Teknikat e biznesit dhe format e organizimit të tij, të praktikuara gjatë kësaj kohe, përfshinin kontrata të hershme, faturat e këmbimit, tregtinë ndërkombëtare në distancë, format e hershme të partneritetit (mufavada) siç janë partneritetet e kufizuara (mudaraba), dhe format e hershme të kredisë, borxhit, fitimit, humbjes, kapitalit, akumulimi i kapitalit, qarkullimi i kapitalit, shpenzimi i kapitalit, të ardhurat, çeqet, vakëfet, llogaritë e kursimeve, llogaritë e transaksioneve, huazimi, kurset e këmbimit, bankierët, këmbyesit e parave, depozitimet, sistemin e kontabilitetit, dhe proceset gjyqësore. Në botën mesjetare islame ekzistonin gjithashtu edhe ndërmarrjet organizative të pavarura nga shteti. Shumë nga këto koncepte të hershme proto-kapitaliste, u avancuan më tej në Evropën mesjetare që nga shekulli i 13 e tutje.

ZHVILLIMI INDUSTRIAL

Industritë aktive të themeluara gjatë kësaj periudhe përfshinin qeramikën, kimikatet, teknologjinë e distilimit, orën, xhamin, instrumentet astronomike, makineritë e fuqizuara nga uji dhe era, mozaikët, pulpat dhe letrat, parfumerinë, naftën, farmaceutikën, bërjen e litarit, transportim detar, ndërtimin e anijeve, mëndafshin, sheqerin, tekstilin, ujin, armët dhe mineralet e tilla si squfuri, amoniaku, plumbi dhe hekuri. Njohuritë për këto industri u përcollën më vonë në Evropën mesjetare, veçanërisht nëpërmjet përkthimeve latine të shekullit të 12-të.

BUJQËSIA

Epoka e Artë Islame dëshmoi një transformim thelbësor në bujqësi, të njohur si "Revolucioni Bujqësor Arab". Tregtarët muslimanë mundësuan shpërndarjen e shumë kulturave dhe teknikave bujqësore nëpër pjesë të ndryshme të botës islame, si dhe arritën të bëjnë përshtatjen e bimëve dhe të teknikave nga përtej botës islame. Të lashtat nga Afrika si melekuqja, agrumet nga Kina, orizi, pambuku dhe kallami i sheqerit nga India, u shpërndanë nëpër tokat islame dhe u përshtatën, të cilat në gjendjen e tyre normale, nuk do të mund të zhvilloheshin në këto zona. Të mbjellat e reja të përshtatura, kombinuar me një mekanizim të shtuar të bujqësisë, çuan në ndryshime të mëdha të ekonomisë.

Gjatë Revolucionit Bujqësor në botën islame, prodhimi i sheqerit u shndërrua në një industri të një shkalle të gjerë, pasi që arabët dhe berberët krijuan plantacionet e sheqerit dhe ndërtuan rafineritë e para. Prodhimi i sheqerit u përhap në të gjithë Perandorinë Islame, që nga shekulli i 8-të.

TEKNOLOGJIA

Inxhinierët dhe shpikësit myslimanë mesjetarë, të tillë si Abbas Ibn Firnas, Benu Musa, Takiud-Din dhe më i shquari i tyre El-Xhezari, prodhuan një numër të konsiderueshëm të shpikjeve.

Gazetari Paul Vallely rendit disa nga shpikjet që kanë ardhur nga Epoka e Artë Islame, ndër të cilat përmend dhomën e errët, kafenë, sapunin, pastën e dhëmbëve, shampon, alkoolin e distiluar, acidin urik, acidin nitrik, valvulën, pompën me piston për thithjen e alternuar, orët mekanike të ujit, zorrët kirurgjikale, mullirin e erës me bosht vertikal, vaksinim, kriptanalizën, analizat e frekuencës, qelqin me ngjyra dhe qelqine kuarcit, tapetin persian, etj.

SHKENCA

Në Botën islame të asaj periudhe, u zhvilluan metodat e hershme shkencore, ku u bë një përparim i rëndësishëm në metodologji, sodomos në veprat e Ibnul-Hejthem (Alhazen), në shekullin e 11-të, i cili konsiderohet pionier i fizikës eksperimentale. Ibnul-Hejthem shkroi Librin e Optikës, me anë të të cilit e reformoi ndjeshëm fushën e optikës. Ai vërtetoi nëpërmjet eksperimentit, se shikimi tek njeriu ndodh për shkak të rrezeve të dritës që hyjnë në sy, dhe shpiku "dhomën e errët" për të treguar natyrën fizike të rrezeve të dritës.

Inxhinierët dhe shpikësit myslimanë mesjetarë, të tillë si Abbas Ibn Firnas, Benu Musa, Takiud-Din dhe më i shquari i tyre El-Xhezari, prodhuan një numër të konsiderueshëm të shpikjeve.

Ibnul-Hejthem është cilësuar gjithashtu si "shkencëtari i parë", për shkak të zhvillimit të metodës shkencore nga ana e tij, dhe puna e tij e shquar në psikologjinë e perceptimit vizual është konsideruar pararendëse e psikofizikës dhe e psikologjisë eksperimentale, edhe pse kjo është ende një çështje debati.

KIMIA

Xhabir ibn Hajjan konsiderohet pionier i kimisë, pasi ai ishte i pari që prezantoi një metode të hershme shkencore eksperimentale në këtë fushë dhe përdorimin e aparateve dhe proceseve kimike të distilimit të pastër, filtrimit, sublimimit, lëngëzimi, kristalizimit, pastrimit, oksidimit dhe avullimit.

Pretendimet e kimistëve për shndërrimin e metaleve, u hodhën poshtë nga shkencëtari mysliman El-Kindi, i ndjekur nga Ebu Rejhan El-Biruni, Avicena dhe Ibn Haldun. Nasirudin El-Tusi deklaroi një version të Ligjit të Ruajtjes së Masës, duke thënë se një trup i përbërë nga materia është në gjendje të ndryshojë, por jo të zhduket. Aleksander von Humboldt dhe Will Durant, i konsiderojnë kimistët myslimanë mesjetarë si themeluesit e kimisë.

MATEMATIKA

Arritjet e matematikanëve muslimanë gjatë kësaj periudhe përfshijnë zhvillimin e algjebrës dhe të algoritmeve nga matematikani persian dhe mysliman Muhamed ibn Musa El-Havarizmi; shpikjen e trigonometrisë sferike, shtimin e pikës dhjetore në numrat arabë të prezantuar nga Sind ibn Ali; shpikjen e të gjitha funksioneve trigonometrike përkrah sinusit; prezantimin e kriptanalizës dhe analizës së frekuencës së El-Kindit; prezantimin e llogaritjes dhe vërtetimit algjebrik nëpërmjet induksionit matematikor nga El-Karaxhi; zhvillimin e gjeometrisë analitike dhe të formulës së hershme të përgjithshme për llogaritjet infinitimale dhe integrale nga Ibnul-Hejthem; fillimin e gjeometrisë algjebrike nga Omer Kajam, përpjekjen e e parë të një gjeometrie jo-Euklideane nga Sadrud-Din; zhvillimin e algjebrës simbolike nga Ebul-Hasan ibn Ali El-Kalasadi, si dhe shumë përparime të tjera në algjebër, aritmetikë, njehsim, kriptografi, gjeometri, në teorinë e numrave dhe në trigonometri.

FIZIKA

Studimi i fizikës eksperimentale filloi me Ibn el-Hejthem, një pionier i optikës moderne, i cili prezantoi metodën shkencore eksperimentale në Librin e tij të Optikës, dhe e përdori atë për të shndërruar në mënyrë drastike të kuptuarit e dritës dhe të shikimit. Ky libër i tiji, është radhitur përkrah librit "Philosophiae Naturalis Principia Mathematica" të Isak Njutonit, dhe konsiderohet si një nga librat më me ndikim në historinë e fizikës, ngaqë inicioi një revolucion shkencor në optikë dhe perceptimin vizual.

Metoda eksperimentale shkencore u fut shpejt në mekanikë nga Biruni.

Disa shkencëtarë muslimanë zbuluan pararendësit e hershëm të "Ligjeve të Lëvizjes" të Njutonit. Ligji i Inercisë, i njohur si ligji i parë i lëvizjes, i Njutonit, dhe Koncepti i Momentit, u zbuluan nga Ibnul-Hejthem dhe Avicena.

Disa shkencëtarë muslimanë zbuluan pararendësit e hershëm të "Ligjeve të Lëvizjes" të Njutonit. Ligji i Inercisë, i njohur si ligji i parë i lëvizjes, i Njutonit, dhe Koncepti i Momentit, u zbuluan nga Ibnul-Hejthem dhe Avicena. Proporcionaliteti midis forcës dhe përshpejtimit, i konsideruar si "ligji themelor i mekanikës klasike" dhe paralajmëruesi i Ligjit të Dytë të Lëvizjes,

14

të Njutonit, u zbulua nga Hibatullah Ebul-Barakat El-Bagdadi, ndërsa Koncepti i Reagimit, që ishte paralajmëruesi i Ligjit të Tretë të Lëvizjes, të Njutonit, u zbulua nga Ibn Baxha (Avempace).

Teoritë që paralajmëronin ardhjen e Ligjit të Gravitetit Universal, të Njutonit, u zhvilluan nga Xha'fer Muhamed ibn Musa ibn Shakir, Ibnul-Hejthem dhe El-Khazini.

ASTRONOMIA

Përparimet e bëra në fushën e astronomisë nga shkolla Maragha, dhe nga paraardhësit e pasardhësit e tyre, përfshijnë ndërtimin e observatorit të parë në Bagdad gjatë mbretërimit të Kalifit El-Me'mun, mbledhjen dhe korrigjimin e të dhënave të mëparshme astronomike (duke zgjidhur problemeve domethënëse në modelin Ptolemaik), zhvillimin e astrolabëve universale, shpikjen e një numri instrumentesh të tjerë astronomikë, fillimin e astrofizikës dhe të mekanikës qiellore (pasi që Xha'fer Muhamed ibn Musa ibn Shakir zbuloi se trupat qiellorë dhe sferat qiellore i nënshtroheshin të njëjtave ligje fizike si Toka), etj.

SHKENCAT E TJERA

Shkencëtarët muslimanë përparuan edhe në shkenca të tjera, si në biologji (anatomi, botanikë, evolucion, fiziologji dhe zoologji), shkencat e tokës (antropologji, hartografi, gjeografi dhe gjeologji), psikologji (psikologji eksperimentale, psikiatri, psikofizikë dhe psikoterapi), dhe në shkencat shoqërore (demografi, ekonomi, sociologji, histori dhe historiografi).

Mes shumë shkencëtarëve të famshëm myslimanë të Epokës së Artë Islame, ishin edhe El-Farabi (një dijetar i gjithanshëm), Biruni (një nga antropologët më të hershëm dhe pionier i gjeodezisë), Nasirudin El-Tusi (dijetar i gjithanshëm), dhe Ibn Khaldun (konsiderohet të jetë pionier i disa shkencave shoqërore, si demografia, ekonomia, historia kulturore, historiografia dhe sociologjia).

MJEKËSIA

Mjekësia islame ishte një zhanër i shkrimeve mjekësore, që u ndikua nga disa sisteme të ndryshme mjekësore. Punime të mjekëve antikë grekë dhe romakë, si Hipokrati, Dioskoridi, Soranusi, Kelsusi dhe Galeni, patën ndikim të qëndrueshëm në mjekësinë islame.

Mjekët myslimanë dhanë kontribut domethënës në mjekësi, në fushat e anatomisë, mjekësisë eksperimentale, të okulistikës, patologjisë, shkencave

Mjekët myslimanë dhanë kontribut domethënës në mjekësi, në fushat e anatomisë, mjekësisë eksperimentale, të okulistikës, patologjisë, shkencave farmaceutike, fiziologjisë, kirurgjisë, etj.

farmaceutike, fiziologjisë, kirurgjisë, etj. Ata gjithashtu ngritën disa nga spitalet më të hershme të specializuara, përfshirë edhe shkollat e para mjekësore dhe spitalet psikiatrike. El-Kindi ishte i pari që demonstroi aplikimin e kuantifikimit dhe matematikës në mjekësi dhe në farmakologji, për të matur forcën e barnave dhe përcaktimin paraprakisht të ditëve më kritike të sëmundjes së një pacienti.

Dijetari musliman El-Razi (Rhazes) zbuloi fruthin dhe lijën. Ebu el-Kaasim (Abulcasis) ndihmoi në hedhjen e bazave për kirurgjinë moderne; në librin e tij Kitab El-Tesrif, ai prezantoi instrumente të shumta kirurgjikale të shpikura prej tij, përfshirë përdorimet në kirurgji të zorrëve, ligaturën, gjilpërën kirurgjikale, tërheqësin dhe shufrën kirurgjikale. Ibn Sina (Avicena) ndihmoi në hedhjen e themeleve për mjekësinë moderne, me librin e tij El Kanun fit-Tibb. Ky dijetar zbuloi sëmundjen ngjitëse, dhe ishte i pari që vuri në zbatim karantinën, për të kufizuar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse. Ai ishte i pari që prezantoi mjekësinë eksperimentale, mjekësinë bazuar në prova, provat klinike, ndarjen e shkencës së mjekësisë nga farmakologjia, etj. Ibn Zuhr (Avenzoar) ishte kirurgu eksperimental më i hershëm i njohur. Në shekullin e 12-të, ai ishte përgjegjës për futjen e metodës eksperimentale në kirurgji, pasi ishte i pari që përdori testimin e kafshëve në procedurat kirurgjikale, para se t'i zbatonte ato tek pacientët njerëz. Ibn-Nefis hodhi themelet për fiziologjinë e qarkullimit të gjakut; ai ishte i pari që përshkroi qarkullimin pulmonar dhe qarkullimin koronar, që përbëjnë bazën e sistemit të qarkullimit të gjakut. Për këtë, ai konsiderohet "fiziologu më i madh i Mesjetës".

ARKITEKTURA

Arkitektura islame më së shumti e shfaq talentin e saj në ndërtimin e xhamive, si Xhamia e Madhe e Xi'an në Kinë (viti 740) , Xhamia e Madhe e Samarras në Irak (viti 847). Myslimanët spanjollë e filluan ndërtimin e Xhamisë së Madhe në Kordoba, në vitin 785, duke shënuar kështu fillimin e arkitekturës islame në Spanjë dhe në Afrikën Veriore. Xhamia dallohet për harqet e saj të brendshme të mrekullueshme. Arkitektura maorike e arriti kulmin e saj me ndërtimin e Alhambra, pallatit/kështjellës madhështore të Granadës, me hapësirat e saj të brendshme të hapura dhe të flladshme, të zbukuruara me të kuqe, blu dhe ngjyrë ari. Muret janë zbukuruar me motive gjethesh të stilizuara, me mbishkrime arabe, vepra dizajni arabeske, dhe me mure të mbuluara me pllaka xhami.

ARTI

Gjatë Epokës së Artë Islame lulëzuan qeramika, qelqi, punimet metalike, tekstilet, dorëshkrimet e ndriçuara dhe punimet e drurit. Lustra e shkëlqyeshme prezantonte kontributin islam në qeramikë. Qeramika islame, e pikturuar me shkëlqim, u imitua nga poçarët italianë gjatë Rilindjes. Kaligrafia, një aspekt thelbësor i arabishtes së shkruar, u zhvillua në dorëshkrime dhe në dekorimet arkitekturore.

LETËRSIA

Libri i Njëmijë e Një Netëve, një përmbledhje e shumë tregimeve të hershme popullore, të treguara nga mbretëresha persiane Sheherazade, është një libër mjaft i njohur i ardhur nga bota islame. Eposi zuri fill në shekullin e 10-të, dhe formën e tij përfundimtare e mori në shekullin 14-të; numri dhe lloji i përrallave të këtij libri kanë ndryshuar nga një dorëshkrim në tjetrin.

Ky libër ka qenë me ndikim në Perëndim, që kur është përkthyer së pari nga Antoine Galland, në shekullin e 18-të, dhe janë shkruar shumë imitime sipas tij, sidomos në Francë. Karaktere të ndryshme nga kjo epikë, si Aladini, Sindbadi dhe Ali Baba, janë bërë ikona kulturore në kulturën perëndimore. Një numër elementësh nga mitologjia arabe dhe mitologjia persiane, tanimë janë diçka e zakonshme në fantazinë moderne, siç janë tapetet magjikë, llambat magjike, etj.

Autorë të tjerë si Ibn Tufail (Abubacer) dhe Ibn El-Nefis konsiderohen si pionierët e novelës filozofike. Ibn Tufail shkroi novelën e parë imagjinare arabe, që e titulloi "Hajj ibn Jakdhan". - *(Vazhdon...)*

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, teologe

https://islamichistory.org/islamic-golden-age

832 VJET PREJ ÇLIRIMIT TË JERUSALEMIT NGA SALAHUDINI, JA PSE E NDEROI DHE EVROPA KOMANDANTIN E FAMSHËM MUSLIMAN

Ishte 2 tetori i vitit 1187 dhe dyert e Jerusalemit u hapën për të gjitha besimet, pas më shumë se një shekulli shtypje. Qyteti frymonte ajër të pastër ndërsa krerët e Kryqëzatave u lejuan të largoheshin të sigurt bashkë me gjërat e tyre.

Ky ishte në kontrast i fortë me atë që kishte ndodhur 88 vjet më parë kur qyteti i shenjtë u pushtua nga kalorësit kishtarë. Më 15 qershor, 1099, ata sulmuan Jerusalemin dhe kryen një masakër të pashpirt ndaj popullatës lokale, e cila kryesisht përbëhej nga muslimanë dhe hebrenj, të cilët deri atëherë jetonin në harmoni.

Besimet e tjera pos krishterimit u ndaluan brenda qytetit gjatë gjithë sundimit të tyre. Vendet e shenjta hebreje dhe muslimane u përdhosën dhe u shndërruan në kisha. Por kur rendi u rivendos në vitin 1187, ushtria e disiplinuar muslimane la të gjitha kishat të paprekura dhe u përpoq të sjell në vete Xhaminë Al-Aksa dhe Kupolën e Shkëmbit. Kjo ushtri ishte e udhëhequr nga Salahudin Ejubi, i njohur dhe nderuar si "Saladini" në perëndim.

Tregimi historik për Salahudinin është ndër të paktat në histori që është i popullarizuar edhe në Perëndim, po aq sa në vendet muslimane. Arsyeja është morali i tij i lartë dhe fisnikëria e karakterit që përshtatet shumë mirë me imazhin perëndimor të një kalorësi ideal. Salahudini lindi në 1137 në një familje kurde në Tikrit në Irakun e sotëm. Ai lindi në një nga kohërat më kritike në historinë mUslimane dhe të krishterë, efektet e së cilës janë të dukshme edhe sot e kësaj dite.

Ushtria e Kryqëzatave, e formuar nga një aleancë mbretërish në Perandorinë Romake, kishte marshuar tashmë në tokat muslimane gjatë shekullit të kaluar. Ata u tubuan nga fjalimet e forta nga Papa Urban II i cili denigroi muslimanët si një "racë e mallkuar" që kishte plaçkitur kisha dhe kishte marrë robëR të krishterët në tokën e shenjtë të Jerusalemit . Kështu, në vitin 1095, Papa Urban II urdhëron Kryqëzatën e parë. Ai kishte përdorur retorikë të ashpër fetare, duke i quajtur të krishterët "racën e zgjedhur" dhe u bëri thirrje të gjithë fisnikëve në të gjithë Evropën të mbështesin një luftë të shenjtë (Kryqëzatat).

Kjo ushtri kishte arritur kapjen e Jerusalemit dhe krijimin e një baze të fortë përgjatë bregdetit të Detit Mesdhe (i quajtur Mbretëria e Jerusalemit) dhe për të pushtuar edhe më shumë toka, gjë që nuk ishin fshehtësi.

Muslimanët, në anën tjetër ishin shumë të ndarë. Në atë kohë përbëheshin nga shumë shtete të vogla të drejtuara nga mbretër dhe sulltanë vendas. Gjatë fëmijërisë së Salahudinit, babai i tij, Najmuddin-i, mori përgjegjësi për të drejtuar qytetin Baalbek, nga i ati, Imadadin Zengi legjendar. Zengi dhe më vonë i biri Nurudin-i dhe nipi Salauhdin-i, u ushqyen nga një dëshirë për të çliruar tokën e shenjtë dhe për të rivendosur paqen.

Ata përmenden për përpjekjet e tyre për të bashkuar kombe të ndryshme muslimane të përhapura në Siri, Irak dhe Egjiptin modern. Nuruddin-i njihet si ideatori i kundër-kryqëzatës ndaj muslimanëve. Ai e kuptoi rrezikun e paraqitur ndërsa shumica e pushtetarëve të tjerë muslimanë ishin të zënë me luftime mes tyre.

Ai përhapi mesazhin e unitetit dhe solidaritetit përmes një rrjeti shkollash të vendosura në të gjithë Sirinë. Arritja e tij kryesore ishte bashkimi i Egjiptit me Damaskun, Aleonin, Edessan dhe Mosulin, për të formuar një front të vetëm kundër drejtuesve të Kryqëzatave.

Koha nuk i dha më shumë hapësirë, meqë vdiq nga një sëmundje në vitin 1174. Ishte ky moment në histori kur Salahudini u ngrit në këtë rast dhe u vendos si trashëgimtar i tij. Salahudini ishte tashmë Vezir (Kryeministër) i Egjiptit në moshën 32 vjeç, dhe vendosi kontrollin mbi pjesën tjetër të tokave që i kishte bashkuar i ati.

Pas kësaj, u zhvillua një luftë e gjatë e cila dëshmoi aftësinë e Salahudinit i cili po mposhtte përfundimisht ushtrinë kryqtare në Hattin, duke iu qasur gjithnjë e më shumë Jerusalemit.

Ishin gjestet e tij bujare dhe përulësia në këtë fitore ato që i dhanë atij admirimin e historianëve evropianë dhe muslimanë.

Ai nuk pranoi që rrugët e Jerusalemit që deri tani kishin rrjedhur me gjakun e muslimanëve dhe hebrenjve, të kishin të njëjtin fat.

Kështu, u kujdes të bënte një marrëveshje e cila thoshte se popullsia e qytetit është e lirë së bashku me pasurinë e tyre.

Ai urdhëroi ushtarët e tij në të gjithë qytetin për të siguruar që nuk kishte plaçkitje. Paratë e mbledhura nga pasuria e mbetur u shpenzuan për mirëqenien e ushtarëve dhe qytetit. Ai i lejoi të gjithë të krishterët që donin të qëndronin në qytet. Arsyeja për këtë bujari ishte se ai nuk u drejtua nga lakmia, inati apo egoja, por qëllimi fisnik për rivendosjen e paqes.

Ai ishte i respektuar dhe i dashur nga miqtë e tij, ndjekësit dhe vendasit. Historia e kujton për vendosmërinë dhe luftën e tij. Ai ndërroi jetë në 1192, në moshën 55 vjeç, pas një sëmundjeje të shkurtër, dhe dha shpirt në Damask.

I shtyrë nga një qëllim i vetëm gjatë gjithë jetës së tij, ai nuk la pas shtëpi, pasuri apo kopshte. Sipas Ibn Shadadit, këshilltarit të tij, ai nuk kishte para të mjaftueshme as për ceremoni varrimi.

Pasuria e tij që mund të kishte lënë, sigurisht që tani do të harrohej. Ajo që nuk u harrua kurrë, ishte parimi i tij i drejtësisë dhe fisnikërisë.

(www.tesheshi.com)

MYFTIU UROI DREJTORIN E RI TË BIBLIOTEKËS SË SHKODRËS

Paraditën e së hënës, më 7 tetor 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, vizitoi drejtorin e ri të bibliotekës së Shkodrës, z. Maxhid Cungu, të cilin e uroi me rastin e marrjes së detyrës.

Në këtë vizitë, në shoqëri edhe të z. Lorenc Luka, Myftiu vlerësoi bashkëpunimin e Myftinisë me bibliotekën e qytetit, sikurse falënderoi edhe kontributin e drejtorit pararendës, z. Gjovalin Çuni, në ruajtjen dhe forcimin e këtij bashkëpunimi me vlerë në drejtim të promovimit të dijes së dobishme.

Bashkëbisedimi u soll rreth botës së librit dhe jetës kulturore në qytetin e Shkodrës, ku u theksua domosdoshmëria e botimeve të reja dhe promovimi i vlerave qytetare nëpërmjet studimit dhe nxjerrjes në pah të traditave dhe kulturës së qytetit të Shkodrës.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu dhe drejtori i bibliotekës këmbyen disa botime të institucioneve përkatëse.

MYFTIU PRITI DREJTORIN PËR BALLKANIN E "KOMISIONIT PËR EVROPËN DHE DY AMERIKAT"

Paraditën e të martës, më 8 tetor 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, drejtorin për Ballkanin e "Komisionit për Evropën dhe dy Amerikat", në Kuvajt, z. Mahmud En-Nexhdi, që shoqërohej edhe z. Samed Shehu, drejtor i Fondacionit "Mirënjohja".

Myftiu i uroi mirëseardhjen në Shkodër mikut të nderuar nga Kuvajti, ku theksoi se bashkëpunimet me qendrat islame dhe fondacionet bamirëse nga Shteti i Kuvajtit i kanë dhënë një frymëmarrje aktivitetit islam në Shkodër e Shqipëri, sidomos nëpërmjet zbatimit të projekteve për ndërtimin e xhamive të reja, mbështetja e vazhdueshme e jetimëve, projektet sociale, etj.

Njëkohësisht Myftiu falënderoi bashkëpunimin e frytshëm me fondacionin "Mirënjohja", që solli edhe mundësimin e fillimit të punimeve për xhaminë e re në lagjen Kiras.

Nga ana e tij, z. Mahmud En-Nexhdi shprehu kënaqësinë e tij për vizitën e dytë në Shkodër brenda këtij viti, sikurse e garantoi Myftiun për vijimësinë e bashkëpunimeve të dobishme në të ardhmen.

Bashkarisht, ata vizituan edhe kantierin e punës, ku po ndërtohet xhamia e re e lagjes Kiras, që ditë pas dite po merr formë dhe po hijeshon zonën dhe qytetin e Shkodrës.

NIS PUNIMET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE: "EDUKIMI JOFORMAL ISLAM NË GJUHËN SHQIPE"

Podgoricë, 12-13.10.2019

Ka nisur punimet Konferenca Ndërkombëtare me temë: "Edukimi joformal islam në gjuhën shqipe", organizuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar të Mendimit Islam. Qëllimi i saj është konsolidimi i infrastrukturës dhe kurrikulave të nevojshme për arsimimin islam të brezave të rinj. Konferenca mbahet në Podgoricë të Malit të Zi, në datat 12-13 tetor, dhe në të do të referojnë 25, akademikë, profesorë universitetesh e medresesh, apo intelektualë që kanë kontribute të njohura në fushën e arsimit islam.

Konferenca u hap me fjalët përshëndetëse nga Rifat Fejziç, Reis i Bashkësisë Islame të Malit të Zi; Dr. Ardian Muhaj, Drejtor i AIITC dhe Prof. Dr. Ahmet Alibašić, Drejtor i Qendrës për Studime të Avancuara, Sarajevë. "Koordinimi i mësimit islam joformal me mësimet në shkollat publike" ishte tema e referatit kryesor mbajtur nga Prof. As. Dr. Ramiz Zekaj, Drejtor i Institutit të Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit, Tiranë. Fillimisht, ai bëri një qasje krahasuese për rrugëtimin e mësim-besimit në dy sisteme, gjatë diktaturës dhe në ditët e sotme. Duke i mëshuar interesit në rritje për edukimin me parimet islame të brezit të ri, ai propozoi krijimin e shkollave fetare alternative, të ndara në 4 cikle, ku fëmijëve do t'u ofrohen dije rreth Islamit, sipas moshave dhe stadit të zhvillimit.

Me interes ishte edhe ligjërata e Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed Sytarit, i cili vuri theksin në ndikimin e hytbes dhe vasit, si mediume të edukimit islam në rajonin e Shkodrës. Referuesit shkëmbyen eksperiencat në fushën e arsimit joformal islam në gjuhën shqipe dhe sfidat me të cilat ata përballen çdo ditë gjatë mësimdhënies.

Emra të tjerë të njohur, si Prof. Dr. Naser Ramadani, Dr. Valon Myrta, Hafiz Safet Hoxha, Prof. Dr. Shaban Sulejmani, Doc. Dr. Ziber Lata, Omer Kajoshaj, Mr. Vaxhide Bunjaku, Mr. Muzaqete Kosumi, Prof. As. Dr. Fahrush Rexhepi, Asoc. Prof. Dr. Muhamed Ali etj., ishin pjesë e ditës së parë të Konferencës Ndërkombëtare me punimet e tyre cilësore dhe shumë të thelluara. Ligjëratat dhe diskutimet do të vazhdojnë edhe në datën 13 tetor, ku në fund të konferencës do të dilet me përfundimet dhe sugjerimet përkatëse.

(www.aiitc.net)

NDIHMOHEN 300 FAMILJE ME JETIMË DHE NEVOJTARË

Paraditën e së shtunës, më 19 tetor 2019, falë kontributit bujar të fondacioneve bamirëse nga Shteti i Kuvajtit, u bë e mundur shpërndarja e 300 pakove ushqimore për familjet e jetimëve dhe nevojtarëve të ndryshëm.

Shpërndarja e këtij kontingjenti, që vjen me ndërmjetësimin dhe përkujdesjen e Komitetit të Bashkuar Kuvajtian për Ndihmë, u parapri nga mesazhi që dha Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vlerësoi këtë kontribut me vlerë, sidomos për shtresat në nevojë.

Myftiu falënderoi Shtetin e Kuvajtit dhe fondacionet e tij bamirëse, si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Komitetin e Bashkuar Kuvajtian për Ndihmë, që në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme ka ndihmuar dhe vazhdon të ndihmojë me qindra jetimë, pa dallim feje, si dhe shumë familje të tjera në nevojë.

AKTIVITET ARSIMOR DHE ARGËTUES NË MES NXËNËSVE TË XHAMIVE GUCI E RE DHE SHTOJ I VJETËR

Të shtunën, më 16 tetor 2019, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi në xhaminë Guci e Re aktivitetin e radhës me temë : "Mësojmë dhe argëtohemi" me nxënësit e kësaj xhamie dhe nxënësit e kurseve fetare të xhamisë Dragoç.

Në këtë aktivitet drejtuesi i arsimit, teologu Arben Halluni, gjatë takimit me nxënësit u mbajti një bisedë fetare, ku u foli për vlerën që ka zhvillimi i mësim-besimit, për njohuritë kryesore të Islamit dhe për edukimin e brezave sipas frymës tradicionale islame, besimit dhe moralit që duhen të karakterizohen me përkushtimin ndaj Zotit (xh.sh), dashurinë dhe paqen më të gjithë njerëzit dhe krijesat e Tij.

Teologu Halluni falënderoi mësuesit e dy xhamive Guci e Re dhe Shtoj i Vjetër për angazhimin e tyre në edukimin e brezave të ri si dhe për gjallërimin e xhamive me veprimtari të ndryshme islame.

Sipas programit të aktivitetit u zhvillua një konkurs fetar në bazë të njohurive fetare (Kur'an, Ilmihal dhe Edukatë Islame) që marrin gjatë procesit mësimor, biseda në mes nxënësve, shëtitje si dhe lojëra të larmishme sportive.

NJË MYSLIMAN I DEKORUAR NGA POLICIA LOKALE E MILANOS: FALË PUNËS SË TIJ U SHPËTUAN SHUMË JETË NJERËZISH

Me datë 4 Tetor në Milano, me rastin e festës së përvjetorit të 159-të të themelimit të policisë lokale, e cila u zhvillua tek komanda qendrore në sheshin Beccaria, agjentë të ndryshëm kanë marrë lavdërimin e komandantit, midis tyre është dhe ndihmësi i policisë gjyqësore Abdesslam Nia.

Në praninë e zv. Kryebashkiakes Anna Scavuzzo dhe komandantëve të policisë lokale të Milanos Ciacci dhe Gherardi, Abduselam Nia nënshtetas italian me origjinë algjeriane është anëtar aktiv i komunitetit islamik të Milanos, ka marrë mirënjohjen prestigjioze për kontributin e dhënë në aktivitete hetimesh delikate, gjë e cila lejoi prishjen e shumë krimeve të rënda.

Zv. Kryebashkiakja Scavuzzi theksoi sesa thelbësore është puna e çdo anëtari të shoqërisë, prandaj duhet ta kryejmë më së miri punën tonë, sepse është shërbimi më i mirë për të cilin qyteti i Milanos ka nevojë.

Gjatë dhënies së dekoratës, Nia është shoqëruar nga komandanti Luca Zenobio, ku dhe u lavdërua për shërbimin e shkëlqyeshëm që ka dhënë.

THIRRJE NGA SHKODRA: QEVERIA TË KTHEJË NË SHQIPËRI FËMIJËT E MBETUR NË SIRI

"Nuk kanë faj fëmijët për gabimet e të rriturve dhe normalisht që diplomacia me të gjitha format duhet të interesohet dhe të luajë rol vendimtar, qoftë dhe për kthimin e një fëmije të vogël, sepse ai është shqiptar. Çdo shqiptar nga më i vogli deri tek më i rrituri është i shenjtë në këto kontekste".

Myftiu i Shkodrës Muhamed Sytari u kërkoi autoriteteve shqiptare që të bëjnë ç'është e mundur për kthimin e fëmijëve shqiptarë të mbetur në Siri

"Ajo që na intereson është se familjet e shqiptarëve të gënjyer apo të mashtruar nga propagandat false të atyre ditëve të kthehen një orë e më parë në vendin e tyre. Sepse nuk kanë faj fëmijët për gabimet e të rriturve dhe normalisht që diplomacia me të gjitha format duhet të interesohet dhe të luajë rol vendimtar, qoftë dhe për kthimin e një fëmije të vogël, sepse ai është shqiptar.

Çdo shqiptar nga më i vogli deri tek më i rrituri është i shenjtë në këto kontekste", tha Sytari në një deklaratë për median.

Çështja është bërë e ndjeshme këto ditë me publikimin e disa rasteve ku fëmijë me prindër të vrarë, kanë mbetur në kampet e luftës. Kohë më parë, u mundësua kthimi në Kosovë i shumë grave e fëmijëve kosovare me të njëjtin fat.

Kryeministri Rama ka thënë se po punon për një kthim të mundshëm të këtij kontingjenti fatkeq.

(www.tesheshi.com)

SHKOLLAT E MYSLIMANËVE MË TË MIRAT NË MBRETËRINË E BASHKUAR

Shkollat e muslimanëve prijnë në listën e shkollave më të mira në Mbretërinë e Bashkuar.

Tre vendet e para në renditjen e të gjitha shkollave të qeverisë së Britanisë së Madhe janë marrë nga shkollat që udhëhiqen nga vlerat Islame.

Shkollat e besimit mysliman kanë kryesuar renditjen e qeverisë Britanike të performancës së shkollave të mesme, duke zënë tre pozicionet e para dhe duke siguruar gjithsej katër vende në dhjetëshen e parë.

E para ishte Shkolla e Mesme e "Tauheedul Islam Girls" në qytetin verior anglez Blackburn, e ndjekur nga shkolla e "Eden Boy" në Birmingham dhe Shkolla e "Eden Girl" në fqinjësi të Coventrys.

Të tre këto shkolla thonë se janë drejtuar sipas vlerave Islamike dhe britanike.

Lista e mbledhur çdo vit nga qeveria rendit shkollat më të mira në të gjithë vendin, duke përfshirë arritjen akademike dhe përqindjen e studentëve që vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm.

Në Mbretërinë e Bashkuar, arsimi i detyrueshëm përfundon në moshën 16 vjeç, pas së cilës studentët mund të largohen për të hyrë në tregun e punës ose të vazhdojnë shkollimin e mëtejshëm.

Sipas kornizës 'Progresi 8' që qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përdor për të matur performancën, shkollat gjykohen sipas përparimit që studentët bëjnë përveç notave që ata arrijnë.

Në "Tauheedul Islam" 83.3 % e studentëve morën nota të larta në Anglisht dhe Matematikë, ndërsa shkolla mori një rezultat 69.9 pikë sipas kornizis Progres 8. Ishte viti i katërt radhazi që shkolla kishte kryesuar tabelën kombëtare.

Të tre kryesuesit u klasifikuan si "Mbi mesataren" sa i përket arritjes nga qeveria dhe u gjykuan si "të jashtëzakonshëm" nga Ofsted – organi i qeverisë Britanike i ngarkuar me sigurimin e cilësisë arsimore si për shkollat shtetërore ashtu edhe për ato private.

Në një deklaratë, Këshilli Mysliman i Britanisë (MCB) tha që statistikat treguan se shkollat e besimit po performonin shumë mirë përkundër perceptimeve negative që i rrethon ata.

"Kredia duhet t'u shkojë mësuesve, prindërve dhe natyrisht studentëve, në këto shkolla fetare myslimane për arritjet e tyre të shkëlqyera," tha Sekretari i Përgjithshëm i MCB Harun Khan.

"Rezultatet e tyre tregojnë se me punë të palodhur dhe përkushtim fëmijët e të gjitha prejardhjeve dhe në çdo mjedis arsimor mund të arrijnë maksimumin e tyre." - U shpreh ai.

(www.kohaislame.com)

DR. SALAHUDIN A. KEFTARO
DAMASK - SIRI

Duajeni njëri-tjetrin sa të jeni gjallë,

SEPSE MALLI PAS VDEKJES,
NUK KA VLERË!

Fshije gabimin,
që të vazhdojë vëllazëria!

E, MOS E FSHIJ VËLLAZËRINË
PËR NJË GABIM!

www.myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek